

THE KOSOVO BANKER

Intervistë ekskluzive me
Ministrin e Financave z. Avdullah Hoti

Inovacioni teknologjik nxit bankat drejt
transformimit dhe modernizimit të
shërbimeve bankare

Shërbimet elektronike dhe pagesat
përmes telefonit



Modernizimi i shërbimeve bankare

Rritja e efijencës
në sektorin bankar



THE KOSOVO BANKER



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK)

është zëri i industrisë bankare në Kosovë. SHBK bashkëpunon me Qeverinë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, mediat dhe opinionin publik, me qëllim të mbështetjes së një industrie të shëndoshë bankare, e cila promovon zhvillimin afatgjatë ekonomik në Kosovë. SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave, duke ofruar një platformë të vetme për lobim të përbashkët, si dhe për diskutimin e iniciativave të reja; identifikon dhe influencon iniciativat ligjore dhe rregullative; bashkërendon aktivitete të përbashkëta për bankat, si dhe promovon aktivitetet bankare përpara audiencës së gjerë. Brenda SHBK-së operon Qendra për trajnime Bankare, e cila ofron trajnime në fushën e bankave dhe të financave.

"The Kosovo Banker" është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy here në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. "Bajram Kelmendi", Nr.15, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

IMPRESSUM

BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

Zt. Robert Wright
Kryetar i Bordit,
Raiffeisen Bank

Zt. Ilir I. Aliu
Zv. Kryetar i Bordit të Drejtorëve,
ProCredit Bank

Zt. Abdurrahman Balkiz
Banka Kombëtare Tregtare

Zt. Albert Lumezi
NLB Prishtina

Zt. Alper Karakoç
IS Bank

Zt. Ayhan Albeyoğlu
TEB Bank

Znj. Merita Gjyshinca-Peja
Banka Ekonomike

Zt. Meriton Sunduri
T.C. Ziraat Bankasi A.S.

Zt. Richard Beasley
Banka për Biznes

DREJTOR EKZEKUTIV I SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS DHE KRYEREDAKTORË

Zt. Petrit Balija

REDAKTORË

Znj. Miranda Rugovaj
Zyrtare e Administratës dhe
Komunikimit

**THE KOSOVO BANKER
MBËSHËTETET NGA FONDI EVROPIAN
PËR EVROPËN JUGLINDORE**



PËRMBAJTJA

EDITORIALI 1-2

SEKTORI FINANCIAR 3-15

- Fjalimi i Guvernatorit Hamza në punëtorinë e organizuar për gazetarë
- Intervistë ekskluzive me Ministrin e Financave z. Avdullah Hoti
- Inovacioni teknologjik nxit bankat drejt transformimit dhe modernizimit të shërbimeve bankare
- Shërbimet elektronike dhe pagesat përmes telefonit
- Vlerësimi i rreziqeve para implementimit të aktiviteteve të reja në banka

KËNDI I EKSPERTËVE 16-18

- Reduktimi i kesh-it dhe zhvillimet e platformave elektronike në sistemin bankar të Kosovës

KËNDI I EDUKIMIT FINANCIAR 19-23

- Indeksi i Çmimeve të Konsumit
- Projekti për edukim financiar të klientëve të bankave

LAJMET E SHBK-së 24-31

- Komitetet në Shoqatën e Bankave të Kosovës Përzgjedhin Kryesinë e Re
- Panairi i Punës nga SHBK dhe EUICC
- Sektori bankar ka shënuar përmirësime të dukshme
- Janë mbajtur trajnimet në kuadër të projektit për Edukim Financiar të Klientëve Bankar
- Shoqata e Bankave të Kosovës takohet me BQK për implementimin e standardeve të Bazël-it

- Shoqata e Bankave të Kosovës merr pjesë në takimin e Komisionit parlamentarë për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri
- Performanca dhe sfidat e sektorit bankar u prezantuan në konferencën 'Aktivizimi i Burimeve të Rritjes Ekonomike në Kosovë'
- Kryetari i Parlamentit krijon zyre për bizneset në Kuvend
- EFSE DF vazhdon përkrahjen për revistën "The Kosovo Banker" deri në fund të vitit 2016

LAJME NGA BANKAT DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE 32-35

- Banka ProCredit dhuron 150,000 çanta të pambukut
- Banka ekonomike dhuron donacion për ndërtimin e qendrës së komunitetit të Down Syndrome Kosova
- BKT angazhohet për shoqërinë
- Raiffeisen ndihmon Qendrën e komuniteteve
- IFC-ja dhe NLB Prishtina punojnë së bashku për të rritur efikasitetin e energjisë në Kosovë
- Dielli TEB Open 2015
- BPB mendon për të vegjëlit - mbështetë One to One Children's Fund dhe projektin "Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur"
- Ziraat Bank

Pikëpamjet e shprehura në shkrimet e revistës janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo politikat e Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE). SHBK dhe EFSE nuk mbajnë përgjegjësi mbi përmbajtjen e artikujve të autorëve të publikuar në revistën "The Kosovo Banker".



EDITORIAL

**Dr. sc. PETRIT BALIJA**

DREJTOR EKZEKUTIV
SHOQATA E BANKAVE
TË KOSOVËS

Të nderuar lexues,

Jeni duke lexuar edicionin e shtatë të revistës "The Kosovo Banker". Kam kënaqësinë të ndaj me ju këtë botim të ri i cili shqyrton modernizimin e shërbimeve bankare dhe rritjen e efikasitetit në sektorin bankar në Republikën e Kosovës.

Shërbimet bankare në mbarë botën janë duke përshkuar një transformim të rëndësishëm përmes mundësive të reja teknologjike duke kaluar nga shërbimet në person apo fizike në shërbimet virtuale apo elektronike. Ky transformim apo modernizim i shërbimeve bankare është duke ndodhur edhe në Kosovë. Bankat komerciale të Kosovës kanë investuar mjaft shumë në avancimin e këtyre shërbimeve gjatë 15 viteve të fundit duke ofruar mundësi dhe qasje në shërbime bankare në mënyrë më të shpejtë, më të lirë dhe të sigurt.

Për klientët e industrisë bankare, instrumentet elektronike të pagesave janë gjithnjë e më shumë të nevojshme, meqenëse mundësojnë

realizimin e pagesave kurdo që ata kanë nevojë, pavarësisht kohës dhe orarit të punës, duke i mundësuar që këtë shërbim ta realizojnë gjatë njëzet e katër orëve. Për këtë arsye edhe përdorimi i tyre është gjithnjë e më shumë në rritje, sikurse mund të vërehet edhe në të dhënat zyrtare statistikore. Në fund të vitit 2014 numri i kartelave bankare ka arritur në 813,026, prej të cilave 83.4% e përbëjnë kartelat me funksion debiti, 14.9% kartela me funksion krediti dhe 1.6% kartela me funksion para elektronike.

Industria bankare ka një infrastrukturë mjaft të mirë të terminaleve të krijuar dhe të shpërndarë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, përmes se cilave kryhen transaksionet duke shfrytëzuar kartelat bankare. Në krahasim me vitin 2009, industria bankare në fund të vitit 2014 ka shënuar rritje për 46.9% në numrin e bankomatëve. Është e rëndësishme të theksohet se industria bankare përveç mundësisë për tërheqje të

parave të gatshme ka krijuar mundësinë që përmes bankomatëve të kryhen edhe pagesa të ndryshme sikurse që janë pagesat xhiro, pagesat për mbushje të telefonave, deponim të mjeteve etj.

Në industrinë bankare krahas rritjes së numrit të bankomatëve është rritur edhe numri i pikave shitëse apo POS që ndihmojnë bizneset e Kosovës që të zhvillohen më shumë dhe të mundësojnë klientëve të tyre pagesa me kartelë në vendin e shitjes. Në krahasim me vitin 2009, industria bankare në fund të vitit 2014 ka shënuar rritje për 78.0% për numrin e pikave shitëse apo 4,098 terminale POS më shumë.

Rritje shumë të ndjeshme në numrin e tyre kanë shënuar edhe llogaritë e-banking. Në krahasim me vitin 2009, numri i llogarive e-banking është rritur për 285% në fund të vitit 2014 dhe njëkohësisht vlerat e transaksioneve janë rritur për 58% nga viti 2013 në vitin 2014.

Të gjitha të dhënat statistikore, tregojnë se industria bankare e Kosovës është duke u orientuar më shumë drejt përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike, pra drejt automatizimit të shërbimeve dhe produkteve pa pas nevojë për prezencë fizike të klientëve në sportelet e bankave. Këto shërbime janë në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të cilat ofrojnë shërbime njëzet e katër orë, pra pa ndërprerje, pavarësisht orarit dhe kohës, duke ofruar në të njëjtën kohë siguri dhe saktësi gjatë përdorimit të

tyre. Këto zhvillime njëkohësisht ndihmojnë në luftimin e pastrimit të parasë dhe luftimi e evazionit fiskal që është më se i domosdoshëm për një zhvillim ekonomik të Kosovës. Këto kanë bërë që të jenë edhe arsyet kryesore se pse instrumentet elektronike të pagesave janë përkrahur nga bankat në Kosovë dhe kanë shënuar rritje signifikante në përdorimin e tyre.

Duke pasë parasysh që jo të gjithë janë të familiarizuar me përdorimin e shërbimeve elektronike bankare, bankat komerciale si dhe Shoqata e Bankave të Kosovës kanë ndërmarrë një projekt për edukimin financiar të klientëve bankar në Kosovë ku komponentë e rëndësishme është edhe përdorimi i shërbimeve elektronike.

Me këtë rast falenderoj bankat komerciale të Kosovës si dhe Fondin European për Europën Juglindore (EFSE) për mbështetjen e këtij publikimi, si dhe një falenderim dhe respekt të madh për autorët dhe stafin që kontribuan në realizimin e këtij edicioni, si dhe lexuesit tanë të përkushtuar që na motivojnë të vazhdojmë me publikime të mëtutjeshme.

Sinqerisht,

Petrit Balija



PUNËTORIA ME GAZETARËT DHE BANKAT KOMERCIALE

(FJALIMI I GUVERNATORIT HAMZA NË PUNËTORINË E ORGANIZUAR PËR GAZETARË)

Ndjej kënaqësi të veçantë që sot gjendem në këtë mes dhe këtë e shoh si vazhdimësi të komunikimit të rregullt që kemi me juve lidhur me çështjet me interes për ekonominë tonë. Pavarësisht se nga pozicione të ndryshme, kur flasim për ekonominë, kemi një qëllim të përbashkët i cili është shfrytëzimi sa më i mirë i resurseve për të siguruar përshpejtim të zhvillimit ekonomik të vendit.

Siç dihet, në çdo vend, ndikim të rëndësishëm në zhvillimet ekonomike kanë edhe pritjet e agjentëve ekonomik. Optimizmi i agjentëve ekonomik ndikon në rritjen e shpenzimeve dhe, rrjedhimisht, nxitë rritjen ekonomike, përderisa pesimizmi i agjentëve çon drejt ngadalësimit të aktivitetit ekonomik. E njëjta gjë vlen edhe

për stabilitetin financiar, ku perceptimi pozitiv i agjentëve e forcon stabilitetin financiar, përderisa perceptimi negativ mund të dëmtojë stabilitetin e sektorit financiar. Për këtë arsye, ne e vlerësojmë lartë komunikimin e drejtë dhe të hapur me mediat, për shkak se përmes juve ne i mundësojmë publikut të kuptojë drejtë zhvillimet financiare në vend dhe, mbi këtë bazë, të ndërtojë pritje racionale mbi gjendjen aktuale dhe zhvillimet e pritshme në sektorin financiar dhe në ekonominë në përgjithësi.

Vlerësimet dhe pritjet e agjentëve ekonomik rreth sektorit financiar shprehen me shkallën e besimit të publikut në këtë sektor. Besimi i publikut paraqet një parakusht shumë të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori. Në këtë kontekst, besimi i publikut ka rëndësi të posaçme sidomos për sektorin bankar duke ditur se afarizmi i bankave në masë shumë të madhe ndërtohet mbi bazën e besimit. Institucionet bankare operojnë me shkallë shumë të lartë të levës, që do të thotë se

ato e zhvillojnë aktivitetin e tyre kryesisht me mjete të huazuara nga burime të ndryshme, siç janë individët, bizneset dhe institucionet tjera financiare.

Në Kosovë, ne jemi të lumtur që bankat gëzojnë besim të lartë të publikut, besim ky që është shprehur nga rritja e qëndrueshme e depozitave që nga fillimi i funksionimit të sektorit bankar në vendin tonë. Në mars 2015, vlera e përgjithshme e depozitave në sektorin bankar të vendit ka arritur në 2.57 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 5.9%. Kjo rritje e qëndrueshme e depozitave ka mundësuar zgjerimin e vazhdueshëm të kredive, të cilat në mars 2015 arritën vlerën prej 1.9 miliardë euro e cila paraqet një rritje vjetore prej 4.3%.

Lidhur me këtë, më lejoni që në vijim të ju paraqes një përmbledhje të faktorëve kryesor të cilët kanë mundësuar zhvillimin e suksesshëm të sektorit bankar, që po vazhdon të shërbejë si baza kryesore mbi të cilën është ndërtuar besimi i publikut në këtë sektor.

1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, si autoriteti rregullativ financiar, ka zbatuar një politikë të shëndoshë të licencimit, e cila ka bërë të mundur që në treg të kemi vetëm banka të shëndetshme, hyrja e të cilave në tregun tonë ka mundësuar rritjen e konkurrencës dhe zhvillimin e suksesshëm të sektorit bankar.

Hapja e tregut për bankat e huaja ka bërë të mundur që sektori bankar, përkundër faktit se filloi të zhvillohet që nga e para, shumë shpejtë të adoptojë praktikat bashkëkohore të bankingut, duke përfshirë si metodat e menaxhimit të rreziqeve bankare ashtu edhe zhvillimin e produkteve bankare. Nga prezenca e bankave të huaja, përfituan edhe bankat vendore të cilat me sukses konvergjuan drejtë standardeve të bankingut modern.

2. Shtyllë tjetër e rëndësishme për zhvillimin e sektorit bankar është korniza rregullative, brenda së cilës rregullohen aspekte të ndryshme të operimit të sektorit bankar. Qëllimi kryesor i rregullativës bankare është që të përcaktojë parimet të cilave bankat duhet t'u përmbahen në mënyrë që të sigurohet se sjellja e tyre nuk

rrezikon stabilitetin financiar dhe me këtë as interesat e depozitorëve dhe investitorëve tjerë.

3. Për të siguruar se sjellja e bankave është në përputhje me kornizën rregullative, pra për të siguruar se sjellja e tyre është në përputhje me parimet e afarizmit të shëndetshëm bankar, BQK-ja në vazhdimësi ka avancuar funksionin e mbikëqyrjes bankare, ku për së afërmi monitorohet aktiviteti i secilës bankë.

Për më tepër, BQK-ja në vazhdimësi monitoron edhe gjendjen e sektorit bankar si tërësi si dhe përpilon analiza përmes të cilave synohet identifikimi i rreziqeve të mundshme që mund t'i kanosen sektorit bankar dhe, mbi këtë bazë, përgatitet për ndërmarrjen e masave adekuate. Për të qenë sa më transparent me publikun, BQK-ja në baza të rregullta publikon materiale të ndryshme, siç është Raporti i Stabilitetit Financiar dhe materiale të tjera, të cilat ofrojnë informacion të hollësishëm mbi gjendjen dhe zhvillimet në sistemin financiar dhe ekonominë në përgjithësi.

4. Në zhvillimin dhe stabilitetin e sektorit bankar, ndikim të rëndësishëm ka pasur edhe zhvillimi i infrastrukturës financiare moderne. Në këtë aspekt, vlen të theksohet se BQK-ja ka zhvilluar një sistemi efikas dhe të sigurt të pagesave, i cili ka mundësuar funksionimin më efikas të sektorit bankar dhe rrjedhimisht edhe të ekonomisë. Poashtu, infrastruktura financiare është zgjeruar edhe përmes regjistrimit të kredive, i cili ka mundësuar përmirësimin e kapaciteteve të bankave për të menaxhuar më mirë rrezikun kreditor.

5. Përveç sjelljes prudeniale të vetë bankave dhe angazhimeve shumëdimensionale të BQK-së për zhvillimin dhe ruajtjen e stabilitetit të sektorit bankar, kontribut të rëndësishëm ka dhënë edhe stabiliteti makroekonomik i vendit. Portofolio kreditorë e sektorit bankar të Kosovës pothuajse në tërësi përbëhet nga kreditë e lëshuara brenda vendit, prandaj çdo ndryshim në performancën makroekonomike të vendit reflektohet në aftësinë paguese të kredimarrësve dhe, rrjedhimisht, në stabilitetin financiar.

Ekonomia e Kosovës gjatë gjithë viteve të fundit ka shënuar rritje, përfshirë periudhën e krizës globale kur shumë shtete, në mesin e tyre edhe shtete të rajonit tonë, shënuan tkurrje të ekonomisë. Parashikimet makroekonomike sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të vazhdojë të shënojë rritje edhe në vitet e ardhshme, duke krijuar kështu kushte për zhvillim të mëtejshëm dhe ruajtje të stabilitetit të sektorit bankar.

6. Të gjithë faktorët dhe zhvillimet që potencova deri më tani kanë dhënë kontribut shumë të rëndësishëm në ndërtimin dhe zhvillimin e sektorit bankar që kemi sot, i cili është në mesin e sektorëve bankar më të qëndrueshëm në rajon por edhe më gjerë dhe me të drejtë gëzon besim të lartë nga publiku.

Për t'iu kthyer numrave, më lejoni të ju paraqes disa nga indikatorët kryesor të cilët e pasqyrojnë shëndetin e mirë që ka sektori bankar i Kosovës. Portofoli kreditor i sektorit bankar ka cilësi mjaft të mirë, me pjesëmarrje të kredive joperformuese në gjithsej kreditë prej vetëm 8.2%, përderisa mesatarja e vendeve të rajonit për këtë tregues është rreth 17%.

Për më tepër, kreditë joperformuese në sektorin tonë bankar janë të mbuluara me mbi 100% nga provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë, që do të thotë se bankat paraprakisht kanë ndarë rezervat e duhura për ballafaqimin me humbjet e mundshme që mund të paraqiten nga këto kredi.

Sektori bankar vazhdon të jetë shumë mirë i kapitalizuar, duke mbajtur në vazhdimësi Treguesin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit në rreth 18%, që paraqet nivel dukshëm më të lartë se minimumi i kërkuar nga Banka Qendrore. Niveli i lartë i kapitalizimit tregon se bankat kanë inkuadruar mjaft shumë kapital vetanak, i cili mund të përdoret për të absorbuar tronditjet e mundshme negative pa rrezikuar mjetet e investitorëve tjerë siç janë depozitorët.

Poashtu, sektori bankar vazhdon të ketë pozicion të fuqishëm të likuiditetit, që do të thotë se bankat kanë aftësi të lartë për të përbushur detyrimet e tyre afatshkurta, si për shembull kërkesat për tërheqje të depozitave.

Në tregun bankar të Kosovës sot operojnë 9 institucione bankare, prej të cilave 7 janë të themeluara me kapital të huaj ose përfaqësojnë degë të bankave të huaja dhe 2 janë banka të themeluara me kapital vendor. Poashtu, në vitin 2014 kemi pajisur me licencë preliminare edhe një degë të huaj bankare

Treguesi i likuiditetit të bankave vazhdon të qëndrojë në mbi 40%, që paraqet nivel mjaft më të lartë se sa minimumi i kërkuar rregullativ prej 25%. Niveli i lartë i qëndrueshmërisë së sektorit bankar sugjerohet edhe nga analiza të tjera, siç është stres-testi, ku bankat në Kosovë paraqiten të afta për të përballuar dhe skenarë hipotetik të konsideruar nën supozime mjaft konservative.

Për të përmbyllur diskutimin tim, po i kthehem edhe një herë pyetjes kryesore që më keni shtruar dhe dëshiroj të ritheksoj se sektorit bankar duhet ti besojmë për shkak se kemi një sektor me banka shumë cilësore, të cilat kanë ndërtuar kapacitete të avancuara për menaxhim të mirë bankar; kemi një bankë qendrore e cila ka ndërtuar kapacitete të avancuara në të gjitha sferat e operimit të saj për të realizuar me sukses objektivat e saj ligjore, ku vendin kryesor e zë ruajtja e stabilitetit financiar; dhe kemi një ambient të përgjithshëm ekonomik, i cili përkundër se nuk po arrin të sigurojë zhvillim të shpejtë të vendit, ka siguruar një shkallë stabiliteti që mundëson ruajtjen e stabilitetit financiar.

Unë ju dëshiroj mbarëvajtje të kësaj punëtorie dhe ju konfirmoj se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjithëherë është e gatshme t'iu përgjigjet pozitivisht organizimeve të tilla që kanë për qëllim rritjen e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet nesh.

Intervistë ekskluzive me Ministrin e Financave z. Hoti

1. Viteve të fundit vërehet trendi i modernizimit të shërbimeve bankare në vend, rajon dhe botë. Si e vlerësoni modernizimin e shërbimeve bankare nga bankat që operojnë në Kosovë?

Deri para disa vitesh, me të drejtë është thënë dhe konstatuar se sistemi bankar në Kosovë është mjaft i kufizuar për sa i përket lloj-llojshmërisë së produkteve dhe shërbimeve që ofron për qytetarët. Megjithatë, zhvillimet e viteve të fundit tregojnë se Bankat në Kosovë janë duke investuar mjaft në drejtim të zgjerimit të gamës së produkteve dhe shërbimeve dhe modernizimit të operacioneve të tyre. Ky lloj investimi tregon për seriozitetin e sistemit në raport me tregun, por njëkohësisht, siguron që sistemi bankar në Kosovë, të jetë në hap me sistemet rajonale, e pse jo edhe me ato evropiane.

Në veçanti, do përmendja lloj-llojshmërinë e shërbimeve elektronike, që gjatë viteve të fundit kanë ndikuar mjaft në mënyrën se si qytetarët komunikojnë me bankat. Këto lloj shërbimesh, jo vetëm që kanë ndikuar në uljen e kostos operationale për bankat, por njëkohësisht kanë bërë që qytetarët të kursejnë kohë në raport me shërbimet që ata kryejnë.

2. Duke pasur parasysh që ky avancim i shërbimeve ju ofron qytetarëve dhe bizneseve një qasje më të lehtë në financa si mendoni që ky modernizim i shërbimeve do të ndikojë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Republikës së Kosovës?

Lidhshmërinë midis avancimit të këtyre shërbimeve me zhvillimin ekonomik të vendit, më shumë do e shikoja në këndvështrimin e përmirësimit të efikasitetit të bankave, gjë e cila mundëson të kemi një sistem bankar më të shëndosh, dhe rrjedhimisht një sistem që është në gjendje të përkrah më shumë edhe sistemin



**Z. AVDULLAH
HOTI**

MINISTËR I
FINANCAVE

ekonomik të vendit. Pra, bizneset dhe qytetarët do të përfitojnë, jo vetëm përmes çmimeve më të përbalueshme për shërbimet bankare, por edhe përmes përkrahjes që sistemi bankar i bënë ekonomisë, në veçanti përmes aktivitetit kreditor.

3. Duke iu referuar zhvillimeve të fundit, çka mendoni sa ka ndikuar industria bankare në zhvillimin ekonomik të vendit?

Si në çdo vend tjetër, edhe në Kosovë zhvillimi ekonomik në masë të madhe varet nga niveli i investimeve, ndërsa investimet janë direkt të lidhura me disponueshmërinë e likuiditetit përmes sistemit bankar. Dhe në këtë drejtim, bankat kanë pasur dhe presim të kenë një rol të një rëndësie të veçante. Megjithatë, janë dy çështje që këtu do të doja ti përmendja: 1) e para, mendoj se Bankat, përmes politikave të tyre kreditore, do të duhej të bënin më shumë në drejtim të zhvendosjes së kreditimit nga financimi për shembull i tregtisë, në sektorët dhe fushat që kanë më shumë vlerë të shtuar për ekonominë, siç është prodhimtaria, bujqësia, etj., dhe 2) e dyta, është parim bazë në ekonomi që niveli i investimeve dhe konsumit, direkt varen nga kostoja e financimit, dhe në Kosovë, normat e interesit vazhdojnë të jenë relativisht të larta.

E kam parasysh që janë një sërë faktorësh që përcaktojnë koston e financimit, por mendoj se janë ndërmarr një sërë reformash që tani e bëjnë pak sa më të lehtë operimin e bankave në treg. Megjithatë, më duhet të them se gjatë viteve të kaluara e sidomos në muajt e fundit, kemi parë një rënie mjaft kualitative të normave të interesit në kredi, dhe shpresoj që kjo të vazhdoj. Jam i bindur se një normë më e ulët e interesit do të ngacmoj më shumë bizneset për të kërkuar financim, dhe kjo do të jetë në të mirë të të gjithëve.

4. Sipas vlerësimeve të fundit nga akterë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, Kosova ka nevojë që të punojë në luftimin (uljen) e ekonomisë jo-formale dhe evazionit fiskal. Sa mendoni që është duke kontribuar sektori bankar në uljen e ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal?

Ne po i ikim fjalës 'luftë', ngase çështja e ekonomisë jo-formale adresohet vetëm përmes partneritetit. Jemi të bindur se zvogëlimi i nivelit të informalitetit në ekonomi, nuk është çështje vetëm e Ministrisë së Financave, Policisë, apo Administratave Tatimore. Një gjë e tillë, kërkon qasje gjithëpërfshirëse në mënyrë që:

- institucionet publike ti kuptojnë drejt brengat e bizneseve dhe qytetarëve, dhe në këtë mënyrë ti adresojmë shkaqet e problemit, para se të merremi me pasojat;
- bizneset dhe qytetarët ti kuptojnë drejt të mirat që sjell formalizimi, duke përfshirë këtu edhe qasjen e tyre më të lehtë në financa, dhe
- ata që nuk i bashkohen sistemit përmes formalizimit, ti kujtojnë drejt pasojat e operimit të tyre në informalitet

Ministria e Financave, së bashku me të gjitha institucione tjera relevante, është duke bërë maksimumin për të zvogëluar shkallën e informalitetit. Reformat e fundit tatimore; përmirësimi i shërbimeve për tatimpaguesit; procesi i fiskalizimit, duke përfshirë këtu edhe skemën për rimbursimin e një pjese të tatimit tek qytetarët; më pas transpareca dhe llogaridhënia e shtuar në mënyrën se si ne hargojmë paratë publike – mendoj se në një periudhë afat-mesme do të bëjë që niveli i informalitetit të ulet ndjeshëm.

Bankat mendoj se kanë një rol mjaft të rëndësishëm në këtë drejtim. Përmes komunikimit të

tyre të përditshëm me bizneset dhe qytetarët, bankat duhet të inkurajojnë secilin që ti bashkohen formalitetit, nga se një gjë e tillë kontribuon direkt në një biznes më të shëndosh për bankat dhe shoqërinë. Jam në njohuri që disa banka veç aplikojnë kushte preferenciale për bizneset që kanë sistem adekuate të raportimit, por inkurajoj të gjitha bankat të bëjnë një gjë të tillë.

5. Një nga kriteret e vlerësimit të raportit vjetor që e bën Banka Botërore është edhe qasja në financa të bizneseve. Raporti i Bankës Botërore për të bërit biznes për vitin 2015, Kosovën e ka listuar në vendin e 23 për qasjen në financa, a mendon se ende ka hapësirë që kjo fushë të përmirësohet?

Renditja në vendin e 23 është mjaft e mirë, marrë parasysh që ky rangim krahason vendin tonë me gjitha vendet e botës që janë pjesë e këtij raporti të Bankës Botërore. Megjithatë, në publikimin e vitit 2015 kishte një rënie krahasuar me atë të vitit 2014 (ku Kosova renditej në vendin e 19). Dua të shtoj këtu se përderisa përmirësimi i renditjes do të ishte i mirë, nëse vendet tjera vazhdojnë me reforma dhe ne mbesim aty ku jemi, renditja në vitet në vijim mund edhe të keqësohet. Prandaj, duhet të vazhdohet me reformat e nevojshme për të lehtësuar qasjen në financa, në mënyrë që të mbrojmë këtë renditje dhe pse jo, të përmirësojmë edhe më shumë.

6. Cilat mendoni se janë sfidat kryesore të industrisë bankare, për të cilat mendoni se institucionet qendrore mund ti ndihmojnë më shumë, në mënyrë që industria bankare të ofroj shërbime edhe më kualitative se sa ato ekzistuese në treg?

Si çdo sektor tjetër, edhe sistemi bankar ka sfida, adresimi i të cilave do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e kualitetit të shërbimeve dhe performancës së këtij sektori. Janë një sërë vepërimesh që institucionet publike po i ndërmarrin, e që mendoj se do të ndikojnë edhe në mënyrën se si funksionojnë bankat. Ndër këto veprime do përmendja:

- reformat në sistemin e drejtësisë, që do të përmirësojnë efikasitetin e këtij sistemi, dhe kjo do të ndikojë direkt edhe në biznesin e bankave
- reformat fiskale, të cilat pritet të kenë ndikim direkt në rritjen dhe zgjerimin e bizneseve, dhe

kjo do të thotë se do të kemi një treg me më shumë potencial për bankat

- iniciativa për themelimin e skemës për sigurimin e kredive, që po përkrahet nga USAID, që do të inkurajoj bankat për një aktivitet më të shtuar kreditor, etj

Këtu dua të shtoj se duke marrë parasysh nivelin e likuiditetit në sistemin bankar, që është mjaft i lart, dhe efektin e reformave të përmendura më lart, por edhe të atyre që nuk i listova, është e pritshme që bankat të rrisin aktivitetin e tyre kreditor. E përmenda më lart se një rritje më e theksuar e kreditimit, do të ndihmonte bizneset dhe qytetarët, por edhe vet bankat, duke marrë parasysh se të hyrat kryesore të bankave vijnë nga interesi në kredi.

7. Çfarë strategjie ka ndjekë Ministria e Financave prej kohës kur ju e keni marrë qeverisjen për t'i ndihmuar bizneseve në Kosovë dhe ne veçanti industrisë bankare për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes?

Reformat e përmendura më lart, të tilla si ndryshimet në politikat tatimore, të miratuara në Qeveri, e që shumë shpejt do të aprovohen në Parlament; përmirësimi i mënyrës së administrimit me tatimet; reformat qeverisëse, etj, do të ndikojnë pozitivisht në biznese dhe ekonomi, dhe rrjedhimisht edhe në sistemin bankar. Për më tepër, reformat në sistemin ligjor, dhe iniciativa për themelimin e skemës së gradacioneve për kredit, direkt do të prodhojnë efekte pozitive.

8. Si është duke funksionuar tregu i letrave me vlerë në raport me industrinë bankare, kur kemi parasysh se bankat komerciale janë akterët primar që bëjnë blerjen në tregun primar?

Deri më tani, ky treg ka ecur sipas planifikimeve. Keni parasysh se emetimi i letrave me vlerë ka filluar relativisht vonë, dhe kemi mjaft për të bërë. Megjithatë, janë ndërmarr një sërë veprimesh që kanë siguruar një fillim të mbarë dhe kjo na siguron ne se edhe në vitet në vijim, tregu i letrave me vlerë do të jetë edhe më i suksesshëm. Kemi zgjeruar akterët e tregut primar, dhe mbetet për të punuar edhe më tej për funksionalizimin e plotë të tregut sekondar.

Jemi në njohuri për kufizimet që kanë bankat e jashtme, në raport me ekspozimin e tyre në investimet në letrat me vlerë, dhe do të shohim nëse në vitet në vijim, do të mund të bëjmë ndonjë zgjidhje, në mënyrë që ato të kenë më shumë hapësirë për të investuar në letra me vlerë. Natyrisht se ky lloj investimi është çështje e strategjisë së bankave, por kufizimet ligjore duket të jenë një sfidë për momentin.

9. Cilat janë rekomandimet tuaja për sektorin bankar dhe ndikimin e këtij sektori në zhvillimin ekonomik të vendit?

Të vazhdojnë me përmirësimin e kualitetit të shërbimeve që ofrojnë; të rrisin edhe më shumë lloj-llojshmërinë e produkteve dhe shërbimeve, dhe padyshim, ajo që e thash më lart, të rrisin më shumë aktivitetin e tyre kreditor



Inovacioni teknologjik nxit bankat drejt transformimit dhe modernizimit të shërbimeve bankare

Jetojmë në shekullin e XXI-të, shekullin e progresit teknologjik dhe të novacionit. Sot është fakt që zhvillimet teknologjike i kanë dhënë një dimension tjetër mënyrës se si jetojmë, si informohemi, si komunikojmë dhe si e perceptojmë realitetin. Për gjenerata të tëra sot është e vështirë të imagjinohet jeta e përditshme dhe puna profesionale pa një mori pajisjesh elektronike. Në këtë kontekst, si çdo fushë tjetër, edhe sistemet financiare në mbarë botën kanë qenë subjekt i avancimeve teknologjike dhe kanë adaptuar me ritme të shpejta teknologjitë më bashkëkohore në fushën e komunikimit dhe të ofrimit të shërbimeve për klientë.

Edhe sistemi bankar në Kosovë, nuk bën përjashtim nga kjo tendencë. Me konfidencë mund të thuhet që vitet e fundit ky sistem ka adaptuar teknologjitë më bashkëkohore, të krahasueshme me ato të vendeve të Evropës Perëndimore me intensitet dhe shpejtësi të admirueshme.

Çfarë ofrojnë shërbimet elektronike për klientët?

Është e padiskutueshme që shërbimet bankare elektronike ofrojnë komfort dhe lehtësi në një realitet ku koha është shumë e çmuar dhe askush nuk ka dëshirë të presë në radhë në sportelet e



**ERIOLA
BIBOLLI**

ZV.DREJTORESHË
GJENERALE

PROCREDIT BANK

bankave. Shërbimet bankare elektronike, në të gjithë botën shihen sot si mënyra më e shpejtë, më e lehtë dhe më e sigurt për të marrë informacion mbi produktet dhe transaksionet e thjeshta bankare, si dhe për të pasur qasje në para dhe në pagesa gjatë 24 orëve në ditë, 7 ditë në javë.

Si rrjedhojë, sot bankat kanë rimodeluar dhe vazhdojnë të jenë në proces të vazhdueshëm të rimodelimit të degëve të veta. Është në rritje numri i bankave komerciale në botë që po kalojnë në konceptin e shërbimit të klientëve përmes kanaleve të shumëfishta të shitjes. Kjo do të thotë që bankat sot po përpiqen të krijojnë në infrastrukturën e vet një ekosistem që kap në tërësi nevojat financiare të konsumatorit, dhe përmes këtij sistemi të ofrojnë kanalin më të përshatshëm dhe më komfort për çdo nevojë të klientit. Bankat po e mundësojnë këtë vetëm duke propozuar një ofertë të integruar të kanaleve të shumëfishta të shitjes, sistemeve inteligjente të informacionit si dhe adaptimit të teknologjive të avancuara në automatizimin e sistemeve të brendshme. Nga ana tjetër, edhe konsumatorët gjithnjë e më shumë po e shohin vlerën e qasjes në paratë e tyre 24/7, dhe po e vlerësojnë lirinë e të mos qenit të kufizuar nga orët e punës së degëve bankare. Kjo tendencë po konfirmohet nga numri vazhdimisht në rritje i klientëve që

kanë kontrata për shërbime bankare elektronike dhe që po i përdorin aktivisht këto shërbime.

Cilat janë kanalet e shumëfishta të ofrimit të shërbimeve bankare?

Në një formë të përmbledhur ndër kanalet më të përdorura të ofrimit të shërbimeve elektronike, me funksione komplementare, mund të përmenden:

Bankimi përmes degëve të bankave, bankimi elektornik apo e-Banking, bankimi përmes telefonit mobil, përmes qendrave të thirrjeve, bankimi përmes kartelave të debitit, bankomateve (ATM), pikave terminale të shitjes (POS) si dhe bankimi përmes Zonave 24/7.

Çfarë shërbime elektronike ofron tregu bankar në Kosovë?

Prej vitesh sektori bankar në Kosovë ka qenë i përkushtuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve për klientë, dhe ka intensifikuar investimet në fushën e teknologjisë bankare. Bankat komerciale përmes adaptimit të teknologjive më të reja kanë mundur qasjen e bizneseve dhe të klientëve në tregjet globale financiare, dhe e kanë përafruar ekonominë kosovare me ekonominë globale.

Në këtë kontekst, Banka ProCredit, institucion me kapital tërësisht gjerman, ka qenë banka e parë në vend që ka sjellë në Kosovë teknologjitë më të reja në industrinë bankare dhe sot përfaqëson një bankë moderne me standarde dhe teknologji të avancuar perëndimore. Ndër arritjet më të spikatura në fushën e shërbimeve elektronike dhe të teknologjisë moderne të bankës ProCredit vlen të theksohet:

1) Kartelat e debitit, bankomatet dhe pikat terminale të shitjes (POS), kanë qenë prej kanaleve të para të shitjes elektronike të ofruara nga Banka ProCredit. Në vazhdim, tregu bankar në Kosovë është pasuruar dhe zhvilluar më tej, dhe instalimi i bankomateve dhe i pikave terminale të shitjes është përcjell nga të gjitha bankat komerciale. Sot Kosova renditet ndër shtetet me mbulueshmëri të madhe në rajon për kokë banori me bankomate dhe POS terminale. Njëkohësisht, klientët kanë në përdorim kartela debiti/krediti të pranuar ndërkombëtarisht, që mundësojnë pagesa dhe tërheqje në para të gatshme me siguri të lartë. Këto shërbime përmes kartelave mund të kryhen 24/7 brenda dhe jashtë territorit të Kosovës.

2) Prej disa vitesh bankat komerciale në Kosovë ofrojnë bankimin përmes internetit e-Banking, bankim ky i cili ju mundëson klientëve qasje të pa limituar 24/7 në llogaritë e tyre bankare. Banka ProCredit ka qenë banka e parë që ka ofruar platformën e bankimit elektronik online e-Banking në Kosovë që nga viti 2005. Ky lloj shërbimi operon plotësisht i pavarur nga orari i hapjes së degëve të bankës dhe përveç sigurisë së lartë, shpejtësisë, fleksibilitetit dhe komoditetit, kostoja e transaksioneve të realizuara përmes e-Banking është më e lirë sesa ato që realizohen në degët e bankës. Klientët mund të informohen lehtësisht për gjendjet e llogarive të tyre, të ekzekutojnë pagesa, të bëjnë transferete të mjeteve.

3) Gjithashtu sektori bankar në Kosovë ofron për klientët e tyre shërbime bankare përmes telefonit mobil apo m-banking. Banka ProCredit gjithashtu ofron në treg një platformë gjithëpërfshirëse bankare në telefonin mobil e cila ofron të gjitha shërbimet standarde si platforma e ban-



kimit elektronik. Me avancimin e teknologjisë së komunikimit në vend, në thelb kjo do të thotë që klientët mund të kenë qasje në llogaritë e tyre dhe të kryejnë një shumëllojshmëri të transaksioneve në çdo kohë.

4) Vitin e fundit, në sektorin bankar janë ofruar zona të integruara të shërbimeve elektronike bankare të quajtura "Zona 24/7", si një kanal tjetër i rëndësishëm shërbimi, krahas rrjetit aktual të degëve. Banka ProCredit, përsëri është banka e parë në treg që vjen me një koncept të tillë të integruar të ofrimit të shërbimeve elektronike bankare. Ky zhvillim përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit dhe harmonizimit të sektorit bankar me ndryshimet më të reja teknologjike në treg. Këto zona janë të hapura 24 orë në ditë gjatë shtatë ditëve në javë, dhe janë të pajisura me bankomate dhe makina për tërheqje dhe depozitim të keshit, përveç kësaj klientët mund të kryejnë edhe një sërë pagesash të faturave mujore, telefon ku në çdo kohë mund të telefonojnë bankën nëse hasin në ndonjë pyetje gjatë kryerjes së shërbimit e shumë shërbime tjera elektronike.

Këto zona ju ofrojnë klientëve mundësi zgjedhje dhe fleksibilitet në përdorimit e kanalit më të përshtatshëm për nevojat e tyre. Transaksionet kryhen thjesht, lehtë dhe me tarifa më të lira se në degët e bankës.

E ardhmja e bankimit në degët e bankave

Pavarësisht përdorimit të kanaleve të shumëfishta të shitjes dhe të shërbimeve elektronike bankare, degët e bankave do të mbeten një prej kanaleve më të rëndësishme për klientët. Është e qartë që përmes degëve klientët do të vazhdojnë të informohen për produkte dhe shërbime bankare më komplekse, do të marrin informacionin dhe këshillimin e nevojshëm për shërbimet bankare, dhe do të vazhdojnë të kryejnë një pjesë të transaksioneve më të ndërlikuara dhe të avancuara si hapja e llogarive, informacioni mbi alternativat për kursime, aplikimi për kredi qoftë kredi biznesi apo hipotekare. Po kështu degët bankare do të vazhdojnë të jenë edhe më tej kanali kryesor për të ndërgjegjësuar dhe ndihmuar klientët për t'i kuptuar shërbimet elektronike, dhe për t'i ndihmuar në përdorimin tyre. Megjithatë, për t'ju përkushtuar më mirë dhe më afër klientëve në këshillim dhe ofrim të produkteve më komplekse, bankat duhet të transferojnë transaksionet e thjeshta rutine në Zonat 24/7, dhe në kanalet elektronike të shërbimit. Vetëm kështu do të mundësohet që punonjësit në degët bankare ti përkushtohen tërësisht një shërbimi më cilësor, më të afërt, dhe më të avancuar për klientë.

Sfida për të ardhmen

Sfide e sektorit bankar në Kosovë mbetet përdorimi i shërbimeve elektronike bankare nga klientët. Bankat duhet të përmirësojnë përvojën dhe eksperiencën e klientëve në përdorimin e kanaleve të shumëfishta të shitjes. Në mënyrë proaktive duhet të inkurajojnë përdorimin më masiv të shërbimeve elektronike.

Në këtë kontekst bankat mund të përdorin disa mekanizma për të inkurajuar sjelljen e klientëve, duke filluar përmes informimit dhe edukimit të vazhdueshëm të klientëve mbi mënyrën e përdorimit mbi avantazhet e shërbimeve elektronike bankare si dhe përmes çmimeve më të favorshme të shërbimeve bankare elektronike.

Në fund, një qasje shumë funksionale dhe e integruar mbi ofrimin e shërbimeve bankare elektronike është e ardhmja e çdo sektori bankar në një shekull ku novacioni teknologjik nuk njih kufij. Shërbimet bankare elektronike ofrojnë përfitime të shumëfishta për sektorin bankar dhe për klientët në përgjithësi. Në njërin anë bankat risin efikasitetin e tyre duke procesuar një numër më të madh të transaksioneve rutine përmes kanaleve të shërbimeve elektronike dhe njëkohësisht do të fokusojnë stafin e tyre në ofrimin e këshillave më cilësore dhe profesionale për klientë. Nga ana tjetër, bizneset, institucionet, organizatat dhe individët privatë mund të plotësojnë nevojat e tyre me një shumëllojshmëri të kanaleve të ofrimit të shërbimit me kosto më të ulët, me qasje të pa limituar 24/7 në mjete dhe me komfort më të lartë. Si rezultat, klientët e bankave marrin shërbime të shpejta dhe cilësore, transaksione më të lira, dhe ka një përfitim të përgjithshëm për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.



Shërbimet elektronike dhe pagesat me telefon

Vala e zhvillimit teknologjik po shtrihet me një shpejtësi të madhe në të gjitha industritë përfshirë edhe sektorin bankar. Sektori bankar ka vazhduar me inovacione të produkteve/shërbimeve dhe klientët janë lidhur ngushtë me bankën e tyre përmes kanaleve të ndryshme: shërbimeve online, ATM-ve, telefonave të mençur apo rrjeteve sociale.

Sektori bankar tani është duke lëvizur në drejtimin e kanaleve dhe pagesave digjitale. Rrjeti i degëve është duke u zvogëluar ngase bankat janë duke investuar më shumë në mundësitë e vetë-shërbimit si: Bankomatët me shërbime të zgjeruara, aplikacione të telefonave të mençur për kryerjen e transaksioneve financiare dhe të shërbimeve tjera elektronike bankare. Shumë klientë tani kanë kaluar nga PC-të e tyre tek telefonat e mençur për ti kryer shërbimet financiare të përmendura më lartë. Pagesat përmes telefonit mobil, në vitin 2015, do të përjetojnë rritjen më të madhe deri tani.

Laptopët, telefonat e mençur, tabletat janë mjete të reja që klientët përdorin për shërbimet bankare sepse duan që përgjigjet ti marrin shpejtë dhe në mënyrë sa më efikase duke pasur kështu komunikim ditorë. Kjo është arsyeja që kanalet e vetë-shërbimeve digjitale janë një portë e rëndësishme për të stimuluar klientët të angazhohen më tepër në përdorimin e shërbimeve digjitale.

Kanalet e vetë-shërbimeve digjitale (digital self-service) kanë filluar të përdoren si mekanizëm operacional për të reduktuar thirrjet dhe për të zvogëluar volumnin e punës në degë. Sot, qëllimi kryesor është t'ju sigurojmë klientëve një

GONETA BATALLI

MENAXHERE

DEPARTAMENTI
I KANALEVE
ALTERNATIVE TË
DISTRIBUIMIT

BANKA KOMBËTARE
TREGTARE



eksperiencë sa më të mirë. Për këtë arsye, tani klientët presin nga bankat që ato çdo herë të krijojnë mundësi të reja shërbimi që kursejnë kohë dhe para.

Sipas statistikave nga Deloitte, në 2015 pritet që, jo vetëm bankat, por edhe kompanitë retail (për individ) dhe shërbimet e ushqimit të fillojnë përdorimin e telefonave mobil të paisur me NFC (Near Field Communication) për të bërë pagesa 'contactless' në dyqane. Tregtarët, gjithashtu, përfitojnë nga kjo metodë e pagesës duke ju mundësuar klientëve transaksione të shpejta. Telefonat mobil të paisur me NFC zvogëlojnë edhe pritjen në rradhë tek POS-i. Dhe, së fundi me pranimin e pagesave përmes telefonave të mençur mund të zvogëlohen disa rreziqe të sigurisë për tregtarët dhe konsumatorin. Me përdorimin e NFC paisjes, tokenizimi krijon një kod unik dhe e dërgon nga telefoni tek paisja NFC e POS-it, dhe numrat e kartës nuk mund të transferohen. Të dhënat e kartës që janë shfrytëzuar për të bërë pagesën përmes telefonit të mençur ruhen në rrjet, re (cloud) apo në telefon duke e bërë të pamundur marrjen e informacionit nga keqbërësit. Apo edhe në rast se ndodh atëherë do të merret informacioni vetëm për një transaksion dhe asnjë më shumë.

Edhe sektori bankar i Kosovës është duke ndjekur nga afër trendet botërore në lidhje me format e

pagesave të reja duke i ofruar klientëve shumëllojshmëri të opsioneve/shërbimeve për të paguar online. Sektori financiar vazhdon të investojë në platforma të reja duke e zgjeruar gamën e shërbimeve online që klientët të mund të kryejnë sa më shumë transaksione financiare në ATM, telefona të mençur dhe në kanale tjera duke evituar kontaktin e drejtëpërdrejtë me punonjësit bankar. Kjo ndihmon që klientët të kryejnë transaksione në mënyrë sa më private dhe konfidenciale, si dhe eviton pritjen në degë.

Sidoqoftë, në Kosovë ende është një numër i vogël i përdoruesve të shërbimeve elektronike duke u krahasuar me trendet në vendet e zhvilluara. Ne duhet të vazhdojmë të punojmë në edukimin e klientëve për të përdorur shërbimet elektronike bankare në mënyrë që, gradualisht, klientët të zhvendosen nga degët në shërbimet online, pasi që tani preferohet më shumë menaxhimi i parasë në mënyrë elektronike.

Në ditët e sotme, edhe ne si BKT, kemi krijuar një sistem shumë të lehtë dhe të shpejt që klientët të qasen në llogaritë bankare përmes shërbimeve elektronike, kudo që jemi, brenda dhe jashtë vendit. Duke filluar nga e-deklaratat, transferet e fondeve, pagesa faturash, pagesat për kartat e kreditit, etj, të gjitha këto kryhen online, përmes shërbimit tonë E-banking. Me E-banking klientët mund të qasen nga kompjuterët, tabletët apo telefonat e mençur të tyre, duke iu mundësuar çasje në llogari 24 orë, dhe kudo që janë. Për më tepër, BKT është banka e parë që ka lidhur marrëveshje me KEDS dhe KUR Prishtina për kryerjen e pagesave të faturave online duke mundësuar që borxhi të shlyhet në kohë reale (menjëherë).

Gjithashtu, ne jemi prezent në të gjithë Kosovën me një numër të konsiderueshëm të ATM-ve, të cilët përveç tërheqjeve, mundësojnë edhe shërbime tjera si mbushjet telefonike, ndryshimin e PIN-it të kartës, dhe së shpejti edhe transfere dhe pagesat e kartës së kreditit.

Në përgjithësi, bankat janë shumë të kënaqura me shërbimet që telefonat e mençur ju ofrojnë klienteve të tyre dhe besojnë që kjo do të gjeneroj klientë të rinj dhe do të rris besueshmërinë e klientëve potencial. Sistemet e pagesave përmes telefonave të mençur, njëkohësisht, i sigurojnë bizneseve që të identifikojnë klient të rinj dhe të mbledhin informata rreth blerjeve të tyre. Duke marr parasysh përdorimin e pagesave përmes telefonave të mençur, përkrahjen e industrisë për zhvillim të mëtutjeshëm në

teknologji, dhe mbështetjen e konsumatorit tek telefonat e tyre për të kryer transaksione, statistikat për pagesat përmes telefonave të mençur do të rriten drastikisht.

Sidoqoftë, tregu i pagesave online bart në vete edhe shumë sfida për sektorin financiar. Bankat duhet të përshtaten dhe të jenë në pajtueshmëri me rregulloret që kërkojnë për të mbrojtur informatat e klientëve dhe të kenë programe të fuqishme të menaxhimit të riskut. Për më tepër, sektori financiar është në garë edhe me industrinë tjera që të jenë sa më inovativ dhe të shkathët për nxjerrjen e produkteve/shërbimeve.

Bankat duhet të vazhdojnë të monitorojnë nga afër rreziqet që ju kanosen nga pjesëmarrësit në sistemin e pagesave përmes telefonave të mençur duke përfshirë: prodhuesit e paisjeve, operatorët mobil, dhe palët e treta të përfshira në krijim të këtyre aplikacioneve. Gjithashtu, ka rreziqe të sigurisë që lidhen me të dhënat personale dhe financiare që kalojnë përmes këtij sistemi.

Ekipet e bizneseve dhe zhvillimit të produkteve duhet të përfshihen në aktivitetet e menaxhimit të riskut nga fillimi, dhe jo të merren aprovimet ose të bëhet lista e kontrollit më vonë. Rreziqet e sigurisë duhet të identifikohen qysh në fazat fillestare.

Duke kuptuar kompleksitetin e pagesave online dhe duke përdor një metodë të shkathët të menaxhimit, bankat mund ta menaxhojnë riskun dhe t'i përmbushin kërkesat e regulatorit si dhe ta shkurtojnë kohën e lansimit të produktit në treg dhe të qëndrojnë konkurrent në të njëjtën kohë. Si përfundim, viti 2015 do të jetë vit i shërbimeve online dhe pagesave përmes telefonave të mençur.



Vlerësimi i rreziqeve para implementimit të aktiviteteve të reja në banka

Zhvillimi i shërbimeve elektronike sjellë përfitime të ndryshme afatgjate për bankën. Aplikimi i shërbimeve të tilla në njerën anë sjell benefite dhe në anën tjetër zhvillon hapësirë për rreziqe të reja. Duke pasur parasysh konceptin e efikasitetit, ofrimit të shërbimeve bankare cilësore dhe të shpejta, banka domosdoshmërisht do të kalojë përmes ndryshimit të disa proceseve të cilat mund të bartin rrezik operacional.

Sipas Basel II, rreziku operacional i bankës "rritet" kur ajo angazhohet në aktivitete të reja si në definimin/lansimin e produkteve të reja dhe poashtu në ndryshim të proceseve interne. Në mënyrë që të ketë siguri që banka i konsideron, kontrollon dhe menaxhon këto rreziqe, duhet të ndërmerren disa hapa para implementimit të shërbimeve të tilla duke i marrë parasysh këto aspekte:

- konsiderimin e rreziqeve potenciale (inherent risks) dhe
- kontrollat e duhura që duhet të shtohen në mënyrë që të mitigohen dhe minimizohen rreziqet.

Specifikisht, gjatë ofrimit të shërbimeve elektronike bankare banka ballafaqohet me një grup të rreziqeve të veçanta, të tilla si rreziku operacional, ligjor, reputacional, etj.

Banka duhet të sigurohet që secili produkt, aktivitet, proces apo sistem i ri të kalojë përmes vlerësimit të rrezikut. Kjo do të jetë e mundur

DAFINA DOBROSHI - KABASHI

UDHËHEQËSE
E RREZIKUT
OPERACIONAL
PROCREDIT BANK
KOSOVA



duke i konsideruar, si minimum, disa aspekte si përshembull aspektin e teknologjinë informative, aspektin ligjor, sigurinë e informacionit dhe burimet njerëzore para implementimit të ndryshimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre faktorëve mund të identifikohen disa rreziqe potenciale të cilat mund të kenë impakt në kontrollat e brendshme në procesin afatgjatë. Kështu, banka sigurohet që të gjitha rreziqet janë vlerësuar dhe të gjitha përgatitjet dhe testet e nevojshme janë përfunduar para implementimit të shërbimeve të reja. Në këtë mënyrë, Banka i identifikon dhe trajton deri në një masë rreziqet para realizimit të shërbimeve të reja.

Reziku Operacional

Reziku operacional, sipas definimit të Basel II, është rreziku nga humbjet direkte ose indirekte si rezultat i proceseve të brendshme jo adekuate, rrezikut nga njerëzit, sistemet dhe ngjarjet nga jashtë. Reziku operacional mund të rritet si rezultat i mashtrimit nga klientët ose nga dizajni jo adekuat i shërbimeve. Disa nga format e mundshme të rrezikut operacional janë:

- rreziqet e sigurisë (përshtatshmëria dhe integriteti në sisteme)
- rreziqet nga dizajnimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit

- rreziku i keqpërdorimit të produkteve/shërbimeve nga klientët

Rreziqet nga siguria shfaqen lidhur me kontrollin e informatave me të cilat banka vepron. Njëra nga rreziqet e sigurisë me të cilat mund të ballafaqohet banka është nga qasjet e paautorizuara në system. Kjo do të thotë që informatat konfidenciale mund të mirren nga personat e paautorizuar. Për të minimizuar rreziqe të tilla, Banka mund të implementoj masa/kontrolla shtesë në mënyrë që të mitigohet ky rrezik. Disa nga masat që mund të merren janë implementimi i "firewall", fjalëkalime, sisteme për enkriptim dhe verifikim të klientëve, etj.

Njëra nga rreziqet nga dizajnimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit është kur punëtorët i pranojnë ndryshimet me veshtirësi. Keqpërdorimi i produkteve dhe shërbimeve nga klientët dhe/apo edhe mashtruesit, është edhe një burim tjetër i rrezikut operacional. Rreziku rritet si rezultat i mungesës së masave të sigurisë gjatë procesit të përdorimit të shërbimeve elektronike bankare. Informatat personale të klientëve të bankës duhet të ruhen gjatë transaksioneve të tilla. Është tejet e rëndësishme që të implementohen mekanizma për raste emergjente si përshtembull Plani për Vazhdimësinë e Biznesit për ta minimizuar sa më shumë rrezikun reputacional i cili mund të rrjedh nga ngjarje të papritura.

Rreziku reputacional

Rreziku reputacional është rreziku negativ nga publiku i cili mund të rezultoj në humbje ose

deri te largimi i klientëve dhe eventualisht dalja e fondeve të klientëve te bankës. Efektet negative mund të kenë impakt material afatgjatë si përshtembull humbja e besimit të publikut në aftësinë e bankës për të vazhduar biznesin. Banka mund të mbrohet nga rreziku reputacional duke ofruar shërbime bankare vazhdimisht dhe në mënyrë konsistente në përputhje me pritjet nga klientët.

Rreziku ligjor

Rreziku ligjor vjen si rezultat i mos respektimit të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në shtetin në të cilin banka operon. Këtu vlen të ceket edhe koncepti i shpëlarjes së parasë. Banka duhet të sigurohet që të konsiderohet edhe aspekti i shpëlarjes së parasë në proceset e shërbimeve elektronike bankare, pra shërbimet elektronike bankare të implementohen në përputhje me ligjet dhe rregullat e aplikueshme. Për t'iu shmangur rrezikut ligjor dhe reputacional, banka gjithashtu duhet të kujdeset për implementimin e rregullave të aplikueshme lidhur me mbrojtjen e të dhënave të klientit.

Duke i pasur parasysh përparësitë e shërbimeve elektronike bankare, bankat duhet të kujdesen që të mirren parasysh aspektet e rreziqeve të ndryshme në mënyrë që këto rreziqe të mitigohen sa më tepër. Mekanizmat efektiv për t'iu përgjigjur incidenteve janë shumë të rëndësishme për ta minimizuar rrezikun operacional, ligjor dhe reputacional që mund të shfaqen si rezultat i surprizave te papritura duke përfshirë sulme të brendshme dhe të jashtme.



Sistemi i Pagesave

- Reduktimi i kesh-it dhe zhvillimet e platformave elektronike në sistemin bankar të Kosovës

Zhvillimet e hovshme dhe risitë në teknologjinë e informacionit, kanë çuar në një avancim të paimagjinueshëm të instrumenteve elektronike në fushën e sistemeve të pagesave, infrastrukturës dhe shërbimeve financiare.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) në këtë drejtim ka ndërmarrë hapa proaktiv në vazhdimësi dhe ka hartuar për këtë qëllim, Planin Strategjik të BQK-së¹ si dhe Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit të Pagesave² që përbën udhërrëfyesin për sistemin bankar të pagesave, për institucionet financiare dhe jofinanciare, për sektorin qeveritar dhe për publikun në përgjithësi.

Pra, duke e ditur se një ekonomi me përdorim të lartë të kesh-it rritë ekonominë joformale, evazionin fiskal dhe krimin në shoqëri, BQK dhe akterët relevantë në kuadër të sistemit të pagesave, kanë ndërmarrë iniciativa dhe veprime, si:

- Rritjen e transaksioneve pa përdorur para të gatshme,
- Studime dhe analiza mbi situatën aktuale, duke përfshirë vëllimin e transaksioneve në para të gatshme dhe atyre pa para të gatshme, shërbimeve elektronike të pagesave, etj.
- Analiza të kostove të bankave, të gjeneruara nga proceset e trajtimit, depozitimit, sigurimit dhe transportit të parave të gatshme.
- Analiza të kostove dhe benefiteve potenciale nga institucionet e mëdha, që gjenerojnë dhe pranojnë pagesa, kompanitë e shërbimeve publike, bizneset, etj.

GJYLFIDANE KADRIJAJ

DREJTORE E DEPARTAMENTIT TË SISTEMIT TË PAGESAVE

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



- Hulumtime mbi përvojën ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, analiza në kuptim me të qartë të boshllëkut se ku ndodhemi dhe ku duam të arrijmë;

Banka Qendrore ka treguar përkushtim të vazhdueshëm duke mbështetur reduktimin e parasë së gatshme me infrastrukturë ligjore, gjë që ka ndihmuar rritjen e sigurisë për përdorim të sistemeve dhe instrumenteve elektronike. Kjo është arritur:

- Duke zbatuar një sërë rregulloresh dhe marrëveshesh në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Duke u nisur me krijimin e sistemit elektronik të kliringut ndërbankar që ka ndihmuar në marrëdhënien *BQK-Bankë Komerciale-Klient*.
- Duke vepruar direkt në krijimin e skemave të pagesave që reduktojnë transaksionet në para të gatshme, si skema e **Pagesave Masive**, skema **Kos Giro** dhe skema e **Debitimit Direkt**.
- Duke krijuar urat e para lidhëse të bashkëpunimit me kompani ndërkombëtare (Visa, MasterCard) dhe atyre që veprojnë në regjione

1 <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2015/BQK-Plani%20Strategjik%202015-2019.pdf>;

2 <http://bqk-kos.org/index.php?id=122>;

të caktuara (Quipu, Pay Link, etj.) për të ndihmuar sektorin financiar në Kosovë përmes asistencës teknike, organizime të seminareve për informim të publikut, për edukim, për trajnim, etj.).

Bankat, bizneset dhe individët janë njëra anë e medaljes për t'i shërbyer reduktimit të parasë së gatshme, ndërsa qeveria me strukturat përkatëse administrative, ka një rol përcaktues në rregullimin e kësaj lëmie.

Institucionet e Qeverisë së Kosovës kanë vepruar në:

- detyrim për hapje të llogarive si dhe për kryerje të transaksioneve bankare për arkëtimet në favor të buxhetit të konsoliduar të shtetit nëpërmjet sistemit bankar
- kryerjen e pagesave dhe të detyrimeve të shërbimeve publike dhe administrative vetëm nëpërmjet llogarive bankare;

Bankat komerciale në Kosovë në veçanti kanë qenë shumë proaktive në drejtim të ndërmarjes së iniciativave dhe veprimeve për zhvillime dhe përshtatje të teknologjive më bashkëkohore, të krahasueshme me ato të vendeve të Evropës Perëndimore.

Aktualisht janë aktive më shumë se 1,9 milionë llogari bankare, 123,978 kartela krediti, 704,359 kartela debiti që mund të përdoren në mbi 9,408 terminale POS, 503 terminale ATM dhe në 159,843 llogari e-banking. Gjatë vitit 2014 përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar janë procesuar 9.1 milionë transaksione me vlerë të përgjithshme prej rreth 6.8 miliardë euro.

Të dhënat statistikore tregojnë shifrat relevante për pesë vitet e fundit, nga ku mund të konstatojmë se ka ende hapësirë për të punuar në rritjen e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Përshkrimi	TM1 2011	TM1 2012	TM1 2013	TM1 2014	TM1 2015
Numri i transaksioneve e-banking Rritje/rënie	86,102 39.2%	110,974 28.9%	200,446 80.6%	309,409 54.3%	472,813 52.8%
Vlera e transaksioneve e-banking Rritje/rënie	220,741,836.94 53.2%	209,803,358.24 -4.9%	471,708,437.56 124.8%	715,857,280.86 51.8%	1,055,730,086.55 47.5%
Numri i transaksioneve DD Rritje/rënie	859 134.1%	2,349 173.5%	2,834 20.6%	3,981 40.5%	3,714 -6.7%
Vlera e transaksioneve DD Rritje/rënie	555,113 14.1%	2,409,702 334.1%	2,142,752 -11.1%	2,076,502 -3.1%	2,224,940 7.1%
Numri i transaksioneve me kartela Rritje/rënie	2,180,695 5.4%	2,725,766 24.9%	3,029,903 11.2%	3,324,599 9.7%	3,580,551 7.7%
Vlera e transaksioneve me kartela Rritje/rënie	182,011,488 8.4%	211,092,545 15.9%	233,886,942 10.8%	261,206,247 11.7%	320,877,802 22.8%

Rrjedhimisht, duke u bazuar në diskutimet me akterë të pagesave në kuadër të ekipit për menaxhim të projektit të reduktimit të parasë së gatshme, ku janë analizuar kostot reale dhe sociale për reduktimin e përdorimit të instrumenteve kesh të pagesave në ekonomi, është konstatuar si në vijim:

- Bankat dhe Institucionet, të angazhohen në edukim të klientit, me promovim direkt të produkteve, me marketing të shërbimeve të ofruara bankare (e-bankingun, kartelat e debitit, kreditit, m-banking, etj.)
- Një resor i rëndësishëm i Sistemit të Pagesave në vend është sigurimi i mundësisë së pagesave elektronike për tatim, taksa, etj. si dhe formave tjera të pagesave me kartela specifike për pensione apo kategori tjera të pagesave;
- Kompanitë e shërbimeve publike dhe institucione tjera, të vendosin POS terminale nëpër sportelet e tyre, për të ju mundësuar klientëve pagesa përmes kartelave;
- Kompanitë të ofrojnë kushte më të volitshme për klientët që paguajnë përmes instrumenteve elektronike, si me Debitim Direkt, p.sh. të ndahen bonuse për konsumatorin që paguan me debitim direkt apo përparësi tjera;
- Kompanitë e shërbimeve publike të ofrojnë mundësi të pagesave përmes e-bankingut (internetit), mobile bankingut, etj.
- Bankat komerciale përmes tarifave të favorizojnë pagesat përmes formave elektronike, duke ofruar tarifa më të ulëta për pagesat përmes llogarive bankare dhe për pagesa elektronike;

BQK ashtu si e ka paraparë edhe në Planin strategjik është në proces të;

Institucionet e Qeverisë së Kosovës kanë vepruar në:

- implementimit të Sistemit të Shlyerjeve Bruto në Kohë Reale (ATS/RTGS+ACH), në pajtim me standardet e fundit ndërkombëtare ISO 20022 unike për pagesa kombëtare dhe ndërkombëtare, pagesa në vlera të vogla apo të mëdha, unike për SEPA dhe TARGET, etj.
- Finalizimit të analizës për mënyrën e krijimit të Sistemit për Shlyerje të Transaksioneve Ndërbankare të Pagesave me Kartela, me qëllim të krijimit të mundësive sa më të lehta dhe më të favorshme për qytetarët e vendit si dhe për ekonominë në përgjithësi, për përdorim të kartelave dhe reduktimin e parasë së gatshme në përdorim.

dorim të kartelave dhe reduktimin e parasë së gatshme në përdorim.

Përparësitë e krijimit të qendrës procesuese për transaksione me kartela në Kosovë, konsiderohet se qëndrojnë në:

- Sigurimin e unifikimit të një POS-i dhe Bankomati që do të ofron një prezantim qoftë edhe në të parë më profesional, më të planifikuar, më eficient për bankat dhe do ishte një pasqyrë e mirë për vendin;
- Do të sigurohej një fleksibilitet për përdorim të kartelës dhe shpejtësi në procesim të transaksioneve me kartelë;
- Do të sigurohej një ulje e shpenzimeve për bankat komerciale, zvogëlim i numrit të terminaleve (ATM dhe POS) në një lokacion dhe shpërndarje më e organizuar dhe më racionale e tyre (rialokim).
- Do të sigurohej një ulje e shpenzimeve për tregtarët/bizneset, që nënkupton përdorimin e vetëm një pajisje për pagesa me kartela duke reduktuar numrin e madh të pajisjeve POS në qendra të shitjeve që ekzistojnë aktualisht;
- Do të mundësohej mbikëqyrja e transaksioneve dhe instrumenteve të pagesave me kartela, meqenëse aktualisht BQK-ja disponon vetëm me statistika të raportuara nga bankat komerciale për transaksione me kartelë.
- Taksat dhe tatimet që rrjedhin nga aktivitetet e qendrave procesuese që bankat komerciale në Kosovë i shfrytëzojnë, nuk shkojnë në buxhet të vendit tonë pasi që shumica nga to veprojnë jashtë vendit, aty ku edhe janë të regjistruara si subjekte legale.

Prandaj, për BQK-në, Institucionet Qeveritare, Bankat Komerciale, Bizneset dhe Kompanitë Publike, ka nevojë për të punuar ende në drejtim të përmbushjes së rregullativës, edukimit-trajnitimit, me qëllim për të stimuluar përdorimin sa me të gjerë të instrumenteve elektronike të pagesave.

Në veçanti, bankat komerciale si akter të rëndësishëm në marrëdhënien ekonomi - klient - kesh, inkurajohen se duhet të veprojnë edhe më me agresivitet për të rritë konkurrencën në tregun bankar, për të rritur cilësinë e shërbimeve bankare, për të bërë uljen e mundshme të tarifave/provizioneve për shërbimet e pagesave elektronike.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe si përdoret IÇK

Çfarë është IÇK?

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matje e ndryshimit mesatar me kalimin e kohës në çmimet e paguara nga konsumatorët urban për një shportë të tregut të mallrave dhe shërbimeve konsumuese.

Çfarë mallra dhe shërbime përfshin Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)?

IÇK përfaqëson të gjitha mallrat dhe shërbimet e blera për konsum nga popullata e referencuar. ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës) ka klasifikuar të gjithë artikujt e shpenzimeve në 83 klasa të konsumit, më tej në 378 produkte (agregat elementar). ASK ka përcaktuar peshën për çdo element agregues dhe çdo muaj grumbullon çmime për secilin agregat elementarë. Shpenzimet janë organizuar në 12 grupe të mëdha. Grupet e mëdha dhe shembuj të secilës kategori janë si më poshtë:

- USHQIMI DHE PIJET JO-ALKOOLIKE (Buka dhe drithërat, mishi, peshqit, djathi, qumështi dhe vezët, vajrat dhe yndyrat, pemët, perimet, sheqeri, reçeli, mjalta, çokollatat dhe ëmbëlsirat, kafja, çaji dhe kakao, uji mineral, pijet joalkoolike, lëngje pemësh dhe perimesh);
- PIJE ALKOOLIKE, DUHAN;
- VESHJE DHE KËPUCË;
- STREHIMI, UJI, RRYMA, GAZI DHE LËNDË DJEGËSE TË TJERA (Pagesa aktuale për banim, mirëmbajtja dhe rregullimi i banesës, furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin, rryma, gazi dhe lëndë djegëse të tjera);
- ORENDITË, PAJISJE SHTËPIE DHE MIRËMBAJTJE E ZAKONSHME E SHTËPISË (Orenditë dhe aparaturat, qilimat dhe mbulesa tjera

XHEMAJL GASHI

MENAXHER I PORTFOLIOS

RAIFFEISEN BANK KOSOVO



për dysheme, tekstile shtëpiake, pajisjet shtëpiake, qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës, veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht, mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme shtëpiake);

- SHËNDETËSIA (Prodhimet dhe pajisjet mjekësore, shërbimet ambulatore, shërbimet spitalore);
- TRANSPORTI (Blerja e automjeteve, përdorimi i pajisjeve për transportin personal, shërbimet e transportit);
- MJETET E KOMUNIKIMIT (Shërbimet postare, pajisjet dhe shërbimet telefonike dhe të telefaksit);
- REKREACIONI DHE KULTURA (Pajisjet audiovizuale, fotografike për përpunimin e informatave, pajisje tjera të qëndrueshme për rekreacion dhe kulturë, artikuj dhe pajisje tjera rekreative, kopshtet, shërbimet rekreative dhe kulturore, gazetatat, librat dhe materialet për zyra, pushime të organizuara);
- ARSIMI;
- RESTORANTET DHE HOTELET (Shërbimet hoteliere, shërbimet për strehim);

Our campus:

The capacity building

- Ndërtimi i kapaciteteve dhe zhvillimi i BNJ-ve të përshtatura sipas nevojave specifike të organizatës suaj;
- Të lidhura me burimet e akredituara ndërkombëtarisht të kolegjit si dhe hulumtimet të aplikuar të IBCM-së;
- Teknika interaktive trajnimi me pjesëmarrësin në qendër për mësim të përshtatshëm;
- Objekte moderne të IBCM-së në Mitrovicë (Veri dhe Jug), apo në lokacionin sipas zgjedhjes suaj;
- Për më shumë detaje:
www.ibcmitrovica.eu/training/

Akreditimi:



Rrjeti:



Qendër testuese:



Donatorët:



Na kontaktoni: www.ibcmitrovica.eu/training/



International
Business College
Mitrovica

From Theory To Practice

- MALLRAT DHE SHËRBIMET E NDRYSHME (Kujdesi personal, gjërat personale, mbrojtja sociale, sigurimet, shërbimet financiare, shërbimet tjera)

IÇK poashtu përfshin tatimet, të tilla si taksat mbi shitje dhe akciza që janë të lidhur direkt me çmimet e mallrave dhe shërbimeve të veçanta. IÇK nuk përfshin artikuj të investimeve, si aksione, bono, pasuri të patundshme, si dhe sigurimin e jetës. (Këto artikuj kanë të bëjnë me kursimet dhe jo në shpenzimet e konsumit të përditshëm.)

Totali i shpenzimeve vjetore të konsumit është përcaktuar si të gjitha blerjet e brendshme (brenda vendit) monetare në sektorin e ekonomive familjare. Kjo përputhet me kategorinë LLK të quajtur Konsumi Final Monetar i Ekonomive Familjare (HFMC) dhe nënkupton se peshat duhet të përjashtojnë vlerën e konsumit të produkteve vetanake dhe koston e banimit nga vetë pronari. Deri në Dhjetor 2014 peshat kanë përfshirë vetëm shpenzimin e konsumatorëve vendas, ndërsa nga Janari 2015 përfshijnë edhe shpenzimet e konsumatorëve jorezident.

Si përdoret IÇK?

IÇK prek pothuajse të gjithë qytetarët për shkak të shumë mënyrave në të cilat përdoret. IÇK është masa e inflacionit më e përdorur gjerësisht. Ajo jep informata në lidhje me ndryshimet e çmimeve në ekonominë e qarkut deri te qeveria, të biznesit, punëtorëve, dhe qytetarëve privatë dhe përdoret nga ana e tyre si një udhëzues për marrjen e vendimeve ekonomike. Përveç kësaj, Qeveria dhe Banka Qendrore përdorin trendet në IÇK për të ndihmuar në formulimin e politikave fiskale dhe monetare.

Pagat reale

Është e rëndësishme të bëhet dallimi në mes të pagave nominale dhe pagave reale. Nëse paguheni me orë, ju paguheni me pagë nominale, e cila është thjesht shuma e parave që ju fitoni në orë të punës. Nëse ju fitoni 20.00 Euro në orë, paga juaj nominale është 20.00 Euro. Megjithatë, paga nominale, në të vërtetë nuk ju tregon se cila është fuqia juaj blerëse për shkak se paga nominale nuk është e përshtatur për inflacion, i cili është një rritje në nivelin e përgjithshëm të çmimeve.

Në anën tjetër, paga juaj reale merr parasysh inflacionin. Një rritje e pagave reale ndodh kur pagat rriten më shpejt sesa inflacioni. Nga ana tjetër, në qoftë se pagat reale rriten më ngadalë se inflacioni, atëherë paga juaj reale - fuqia juaj blerëse - ka rënë. Është e rëndësishme për ju të dini pagën tuaj reale për të përcaktuar nëse një rritje në pagën tuaj në fakt ka rritur pasurinë tuaj, thjesht duke e mbajtur ritmin me shpenzimet në rritje, apo më keq, duke rënë prapa rritjes së çmimeve.

Paga reale heq efektin e rritjes së çmimeve, dhe na tregon se çfarë vlere ka paga me të vërtetë në drejtim të blerjes së mallrave dhe shërbimeve. Ajo na ndihmon të krahasojmë pagat në vite të ndryshme, si dhe pagat në qytete të ndryshme me kosto të ndryshme të jetesës. Le të shohim disa shembuj dhe të mësojmë se si të rregullojmë pagat për inflacionin.

Formula për llogaritjen e pagave reale

Formula për të llogaritur pagën reale është relativisht e thjeshtë. Le të shohim se si mund ta bëjmë atë me indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK), i cili është lehtësisht në dispozicion në internet nga ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës).

Indeksi i çmimeve të konsumit është një nga disa indekset e mallrave dhe shërbimeve për konsumatorët që i mbajnë gjurmët e ndryshimeve në nivelin e çmimeve. Ju mund të përcaktoni nëse çmimet janë në rritje ose rënie prej vitit në vit duke rishikuar numrat. Ju mund të përdorni formulën e mëposhtme, së bashku me IÇK, për të llogaritur pagat reale:

Paga Reale = (Paga e Vjetër x IÇK e Re) / IÇK e Vjetër

Shembull

Paramendoni se në vitin 2010 paga juaj nominale ishte 800 Euro në muaj dhe pranuar një rritje 2% të pagës në vitin 2011, duke e bërë pagën tuaj nominale 816 Euro në muaj. Indeksi i çmimeve të konsumit për vitin 2010 ka qenë 113.5 dhe në vitin 2011 ishte 121.8. Cila ishte paga juaj reale?

$$\text{Paga Reale} = (800 \times 121.8) / 113.5$$

858.50 është fuqia juaj blerëse - sa paga e 2011 (800) mund të blejë në vitin 2011.

Për të gjetur se sa fuqi blerëse keni fituar ose humbur gjatë vitit të ardhshëm:

- Zbrit: Fuqia blerëse në 2011 e pagës së vjetër minus paga e re

$$858.50 - 816 = 42.5$$

- Pjesto: Përgjigja e mëparshme në fuqinë blerëse të vitit 2010 të pagës së vjetër

$$42.50 / 816 = 0.052083333 = 5.21\%$$


(Leviz presjen dhjetore dy vende në të djathtë për të marrë një përqindje)

Paga juaj reale ka rënë për 4.95% gjatë 1 viti. Në vitin 2011, ju jeni duke fituar 95.05% të asaj që keni fituar 1 vit më parë, në aspektin e fuqisë blerëse.

Mund të llogaritni të ardhurat tuaja reale ose pagën reale, duke përdorur Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) të raportuar çdo muaj nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). IÇK tregon ndryshimet e përgjithshme në çmimet e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të blera nga familjet. (Indeksi me më figurat e përditësuara është në dispozicion nga ASK, në <http://ask.rks-gov.net>)

Zhvillimi i IÇK, 2003 - 2014

Burimi: ASK



Projekti për edukim financiar të klientëve të bankave



Me një konferencë të organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës dhe IFC-ja si pjesë e grupit të Bankës Botërore zyrtarisht u lansua projekti për edukim financiar të klientëve bankar. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të Bankës Botërore, IFC-së, Shoqatës së Bankave të Kosovës, përfaqësues të bankave anëtare si dhe pjesëmarrës të tjerë.

Në fjalën e saj hyrëse znj. Syzana Dautaj falënderoi Shoqatën e Bankave të Kosovës për bashkëpunimin e shkëlqyer në këtë projekt.

Ndërsa nga ana e Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija vlerësoi lartë këtë projekt dhe theksoi edhe një herë rëndësinë e edukimit financiar. Ndër të tjera ai tha 'Shoqata e Bankave të Kosovës duke nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me IFC-në në korrik 2014, hodhi hapin e parë të këtij projekti duke treguar kështu një përkushtim për edukimin financiar të klientëve. Qëllimi i projektit për edukim finan-

ciar të klientëve është që të ndihmojë në rritjen e aftësive dhe njohurive të klientëve egzistues dhe klientëve potencial të bankave në Kosovë mbi bazat e financave'.

Në kuadër të këtij projekti janë publikuar videot vetëdijësuese në fushën e e-banking, huazimit të mençur dhe karakteristikave të produktit. Këto video kanë për qëllim të rrisin edukimin financiar të klientëve duke i bërë ata klient proaktiv të cilët janë të informuar mirë për financat personale, kuptojnë karakteristikat e produkteve bankare dhe rrjedhimisht bëjnë huazim të mençur.



Drejtori ekzekutiv i SHBK-së z. Petrit Balija në fjalimin e tij gjatë konferencës

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija tha “SHBK në kuadër të strategjisës së saj për edukim financiar, ka mbështetur projektin financiarisht, përderisa IFC, anëtare e grupit të Bankës Botërore, ka punuar së bashku me SHBK-në në realizimin e Projektit për Edukim Financiar, në mënyrë që të përmirësojë nivelin aktual të edukimit financiar të popullatës, posaçërisht duke targetuar klientët ekzistues dhe potencial të bankave në Kosovë”.

Në mënyrë që klientët të kenë kuptim më të gjerë të financave personale, përveç kampanjës vetëdijësuese, projekti për Edukim Financiar të Klientëve Bankar parasheh të ofrohen trajnime falas për klientët e bankave në këto fusha: Menaxhimi i financave personale, huazimi i mençur dhe kursimet.

Gjatë konferencës u bë edhe dorëzimi zyrtar i materialeve të projektit nga IFC-ja tek Shoqata e Bankave të Kosovës.

Me këtë rast, u ndanë certifikatë mirënjohje për të gjitha bankat komerciale në Republikën e Kosovës për kontributin e dhënë në implementimin e projektit për Edukim Financiar.

Ky projekt është përkrahur nga bankat anëtare të Shoqatës së Bankave të Kosovës (Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare, Banka për Biznes, IsBank, NLB Prishtina, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank dhe TEB Bank), IFC-ja si pjesë e grupit të Bankës Botërore, Master Card International, Visa International dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.



Dorëzimi zyrtar i materialeve të projektit për edukim financiar nga IFC tek SHBK

HUAZIMI I MENÇUR



KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PRODUKTEVE TË BANKËS



E-BANKING



Komitetet në Shoqatën e Bankave të Kosovës Përzgjedhin Kryesinë e Re

Në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) funksionojnë dhjetë komitete të fushave të ndryshme të sektorit bankar. Komitetet përbëhen nga përfaqësues respektiv të tetë anëtarëve të SHBK-së. Komitetet kanë funksio-

ne tejet të rëndësishme për të trajtuar çështje specifike që ndikojnë në funksionimin më të mirë të sektorit. Në pjesën e dytë të vitit 2014 u bë përzgjedhja e kryesisë së re në disa nga komitetet aktive në SHBK.

Komitetet të cilat kanë përzgjedhë kryesinë e re janë:

Emri i komitetit	Kryetari i përzgjedhur	Institucioni	Nënkryetari i përzgjedhur	Institucioni	Data e përzgjedhjes së kryesisë së re
Komiteti i Pajtueshmërisë dhe AML-së	Ali Krasniqi	BKT	Alban Hetemi	ProCredit Bank	24 tetor 2014
Komiteti Ligjor	Agron Krasniqi	BpB	Ilir Gaxha	TEB Bank	17 dhjetor 2014
Komiteti i Financave	Rezak Fetai	ProCredit Bank	Rudin Lleshaj	BKT	23 tetor 2014
Komiteti i Marketingut dhe PR	Antigona Bejtullahu	Raiffeisen Bank	Zana Rizvanolli	NLB Prishtina	22 shtator 2014
Komiteti i Riskut	Gem Maloku	NLB Prishtina	Besian Mustafa	TEB Bank	17 shtator 2014

Ashtu siç edhe është e përcaktuar në procedurat e punës së këtyre komiteteve, mandati i kryesisë së re është dyvjeçar.

Drejtori Ekzekutivë i SHBK-së z. Petrit Balija dhe stafi i SHBK-së shfrytëzojnë rastin të falënderoj

të gjithë përfaqësuesit e kryesive të kaluara për punën dhe kontributin e palodhshëm të dhënë gjatë mandatit të tyre, përderisa ju dëshiron shumë suksese kryesive të reja të zgjedhura.

Panairi i Punës nga SHBK dhe EUICC

Rreth 200 të rinj që studiojnë apo kanë mbaruar studimet Bachelor/Master në drejtimet përkatëse, kanë shfrytëzuar panairin e punësimit me bankat komerciale të mbajtur në Qendrën Informative dhe Kulturore të BE-së në Prishtinë për t'u njoftuar mbi mundësitë e punësimit apo mbajtjes së praktikës në industrinë bankare.

Panairi u organizua nga Qendra Informative dhe Kulturore e BE-së (EUICC) në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës (SHBK) dhe në të morën pjesë pesë banka komerciale: Raiffeisen Bank, Pro Credit Bank, NLB Prishtina, Banka Kombetare Tregtare dhe İşBank.

Përfaqësuesit e bankave shpalosën para të interesuarve mundësitë që ofrojnë për praktikë profesionale dhe punësim, teksa mblodhën CV të kandidatëve që shfaqën interesim për t'u punësuar në sektorin bankar. Panairi i Punës ishte një mundësi për studentët apo të diplomuarit që të takohen sy më sy me përfaqësues të bankave, të cilët rekrutojnë kandidatë të suksesshëm për punë. Ai ofroi një pasqyrë më reale të tregut të punës në industrinë bankare,

që është mjaft atraktive për të rinjtë. Në këtë mënyrë studentët paten mundësinë që ta kuptojnë se tregu është mjaft konkurrues dhe ata duhet të përgatiten mirë profesionalisht që të arrijnë të punësohen.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija theksoi rëndësinë e angazhimit të të gjithëve për uljen e papunësisë në Kosovë. "Punësimi është çelësi i shumë prej problemeve me të cilat ballafaqohet shteti ynë i ri. Prandaj është me rëndësi që të vëhen në lëvizje jo vetëm qeveria e Kosovës por edhe sektori privat, organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile, universitetet dhe kolegjet si dhe mediat në mënyrë që të gjithë të kontribuojmë në uljen e papunësisë për të përmirësuar perspektivën e të rinjëve në Kosovë", tha ai.

Panairi i punësimit me bankat komerciale në Kosovë është pjesë e fushatës së Qendrës Informative dhe Kulturore të Bashkimit Evropian për zhvillimin ekonomik. (Zeri, Kosova Sot, Telegrafi, 27 shkurt, 2015)



Sektori bankar ka shënuar përmirësime të dukshme

Delegacioni i Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Kosovë, të premtën është takuar me zyrtarë të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) të cilët po vizitojnë Kosovën këto ditë. Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balijs, ka deklaruar se në këtë takim u diskutuan arritjet e sektorit bankar në Kosovë dhe mundësitë e mëtutjeshme për përmirësime.

Gjithashtu u identifikuan dhe diskutuan se cilat janë përmirësimet që duhet bërë për të përmirësuar mjedisin për të bërë biznes në Kosovë me theks të veçantë në zbatimin e kontratave si një fushë që ka ngecur dukshëm në Kosovë dhe që është jetike si për bankat dhe bizneset tjera që operojnë në Kosovë, ashtu edhe për investime të huaja direkte.

Për më shumë, sektori bankar ka shënuar përmirësime të dukshme si në normat e interesit për kredi ashtu edhe në mbajtjen e kredive jo performuese në nivele më të ultat në rajon. Kjo tregon një stabilitet të mirë të industrisë bankare në Kosovë dhe siguri për depozitorët, shtoi në fund zt. Balijs. Fondi Monetar Ndërkombëtar në këtë takim u përfaqësua nga përfaqësuesi rezident i FMN-së për Kosovë, zt. Frank Lakëijk, zt. Giuseppe Cipollone ekonomist i lartë i Departamenti

Evropian, zt. Jason Weiss ekonomist – Departamenti Evropian, znj. Aleksandra Zdzienicka, ekonomiste, Departamenti për Strategji, Politika dhe Rishikim, zt. Florian Misch, ekonomist Departamenti i Çështjeve Fiskale, zt. Selim Thaçi, ekonomist, zyra e përfaqësuesit rezident në Kosovë dhe zt. Jacques Miniane, shef i misionit të FMN-së për Kosovë, Departamenti Evropian. Në këtë takim ishin prezent edhe të gjithë kryeshefët ekzekutiv të bankave komerciale që operojnë në Kosovë, anëtarë të SHBK-së. (Agjencia e lajmeve *Ekonomia*, Kosova live, 23 mars, 2015).



Janë mbajtur trajnimet në kuadër të projektit për Edukim Financiar të Klientëve Bankar

Më 23 - 17 Shkurt u mbajtën trajnimet e planifikuara në kuadër të projektit për Edukim Financiar të Klientëve Bankar, projekt i cili është iniciuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) dhe do të zbatohet në bashkëpunim me Korporatën Ndërkombëtare Financiare (IFC, pjesë e Bankës Botërore).

Zyrtarët përkatës të anëtarëve të SHBK-së kaluan trajnimet me sukses dhe u certifikuan në dy fusha. Trajnimi i parë zgjati 2 ditë dhe i certifikoi trajnerët nga bankat anëtare në temën Trajnimi i Trajnerëve, të cilët pastaj do të mbajnë



trajtime dhe punëtori të ndryshme për klientët e tyre, në temat Menaxhimi i Financave Personale (Familjare), Kursimet, dhe Huamarrje e Mençur. Projekti parasheh që, brenda dy viteve të ardhshme, të trajnohen së paku 3000 klientë të bankave dhe individë tjerë të interesuar.

Trajnimi i dytë, Trajnimi i Këshilltarëve, zgjati 3 ditë dhe kishte për qëllim certifikimin e pjesëmarrësve që të trajnojnë stafin e tyre të brendshëm në shërbim të klientëve për të komunikuar në mënyrën e duhur me klientë të ndryshëm, në mënyrë që të kuptojnë kushtet e parapara të kontratave dhe të kuptojnë se si funksionojnë marrëdhëniet e tyre me bankën. Projekti në fjalë ka edhe aktivitete tjera gjatë dy viteve të ardhshme, ku përfshihen fushata në medime të ndryshme dhe aktivitete për ngritjen e vetëdijes lidhur me shërbimet bankare.



Shoqata e Bankave të Kosovës takohet me BQK për implementimin e standardeve të Bazel-it

Sot, më datë 3 prill, Shoqata e Bankave të Kosovës e përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv z. Petrit Balija dhe kryetari i Komitetit Ligjor z. Agron Krasniqi, pritën në një takim pune ekipin e projektit për implementimin e standardeve të Bazel-it, i kryesuar nga z. Ralf Raab, këshilltar i lartë pranë departamentit të Mbikëqyrjes Bankare në BQK. Ky takim kishte për qëllim prezantimin e projektit të Implementimit të standardeve të Bazel, i cili veçse është në proces, si dhe të krijoj marrëdhënie bashkëpunimi mes SHBK, z. Raab dhe ekipit të tij i cili përfshin stafin nga BQK dhe konsulent të jashtëm.

Gjatë takimit u prezantuan objektivat e projektit për implementimin e standardeve të Bazel-it dhe format e bashkëpunimit me SHBK. Për këtë takim drejtori ekzekutiv i SHBK-së z. Balija tha 'Ky projekt ka një vlerë të veçantë për industrinë bankare në Kosovë pasi që paraqet përmbushje të kriterëve ndërkombëtare për funksionimin më të mirë të sistemit bankar dhe integritetive të mëtutjeshme në arenën ndërkombëtare financiare. Ky projekt është duke u mbështetur nga organizata gjermane GIZ. (Botapress, 3 prill 2015)



Shoqata e Bankave të Kosovës merr pjesë në takimin e Komisionit parlamentarë për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri



Prishtinë [5 maj 2015] – Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) e përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv z. Petrit Balijsa mori pjesë në një takim të përbashkët të Komisionit parlamentarë për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri dhe Komisionit parlamentarë për Legjislacion Mandate, Imunitete, me pjesëmarrje të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Odave Ekonomike, për të diskutuar lidhur me kontestet biznesore dhe mos-efikasitetin e gjykatave në zgjidhjen e rasteve të tyre.

SHBK me anë të një shkrese zyrtare drejtuar paraprakisht Komisionit për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri ka adresuar disa nga sfidat me të cilat ballafaqohet industria bankare.

Në lidhje me këtë takim, drejtori ekzekutiv i SHBK-së, z. Balijsa tha “Krahas shumë faktorëve të tjerë të riskut me të cilët ballafaqohet sistemi bankar në Kosovë, sistemi i drejtësisë paraqet një nga faktorët e rëndësishëm i cili e rritë ndjeshëm ambientin e riskut në të cilën vepron ky sektor. Sipas raportit për Të bërit biznes 2015, të Bankës Botërore, Kosova listohet në vendin 138 për zbatimin e kontratave nga gjithsej 189 vende në rang-listë dhe kjo duhet të ndryshojë në mënyrë që industria bankare mos të hasë në vështirësi në të ardhmen.”

Komisionet parlamentare u zotuan se do të bëjnë gjithë çfarë është e mundur për të zgjedhur këto probleme në sistemin e drejtësisë të cilat janë identifikuar nga shoqatat e bizneseve dhe odat ekonomike.

Performanca dhe sfidat e sektorit bankar u prezantuan në konferencën ‘Aktivizimi i Burimeve të Rritjes Ekonomike në Kosovë’

Prishtinë [15 maj, 2015] – Shoqata e Bankave të Kosovës e përfaqësuar nga kryetari i Bordit të drejtorëve z. Robert Wright mori pjesë në sesionin e parë të konferencës ‘Aktivizimi i Burimeve të Rritjes Ekonomike në Kosovë’.

Sesioni i parë trajtonte temën ‘Investimi për rritje-Mjedi biznesor dhe kufizimet e tij’, ku në mesin e panelistëve të cilët vinin nga institucione të ndryshme si Ministria e Financave, Banka Botërore, Institute dhe universitete të

ndryshme, z. Wright dha një prezentim mbi performancën dhe sfidat e industrisë bankare në Kosovë. Ndër të tjera në prezentimin e tij z. Wright përmendi një ndër sfidat më të theksuara të sektorit bankar, por edhe të sektoreve tjera në Kosovë, e që është zbatimi i kontratave. Sipas vlerësimit të Bankës Botërore, Kosova radhitet në vendin e 138-të në raportin e të bërit biznes, sa i përket zbatimit të kontratave, duke qëndruar kështu dukshëm në pozitë më të dobët se vendet e rajonit, dhe duke pamundësuar zhvillime pozitive në ekonominë e Kosovës.

Ndërsa, Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija vlerëson se është shumë pozitive që të mbështetën këto platforma të debatit dhe dialogut për zhvillim ekonomik pasi që në këtë formë mund të identifikohen sfidat dhe mundësitë e zhvillimit të mëtutjeshëm ekonomik.

Kjo konferencë është organizuar nga Instituti Riinvest me mbështetje të Shoqatës së Bankave të Kosovës si një ndër sponsorët kryesorë, me rastin e njëzet vjetorit të themelimit të këtij instituti.



Kryetari i Parlamentit krijon zyre për bizneset në Kuvend

Prishtinë [15 maj, 2015]– Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli ka bërë të ditur se ka vendosur që t'i jap komunitetit të biznesit një zyrë në Kuvendin e Kosovës në mënyrë që bizneset të kenë qasje më të mirë në hartimin dhe ndryshimin e ligjeve për ekonominë.

Veseli e ka bërë këtë të ditur gjatë konferencës së organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës me temë "Dialogu dhe partneriteti me komunitetin e Biznesit në hartimin e Legjislacionit". Veseli tha me këtë rast se këtë vendim po e merr me qëllim që të hartohen ligje sa më të mira të cilat do ta shtyjnë përpara zhvillimin ekonomik. "Kam marrë një vendim për krijimin e një zyre suaj në Kuvend në mënyrë që të keni qasje më të afërt me deputetët në hartimin e legjislacionit për ekonominë" ka thënë Veseli.

Ai ka shtuar se këtë vendim e ka marrë për dy arsye të rëndësishme që janë bërja e ligjeve sa më të mira për zhvillimin ekonomik përmes këshillave profesionale nga bizneset dhe për rritur mundësinë e shndërrimit të ideve inovative të ndërmarrësve në ligje sa më të mira për ekonominë.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Balija ka falenderuar kryetarin Veseli

për mundësinë e dhënë për këtë takim, si dhe për hapjen e zyrës përfaqësuese të bizneseve. Ai ka shtuar se industria bankare ballafaqohet me problem të ngjashme si bizneset e tjera në Kosovë, ku kontratat nuk gjejnë zbatim, ku informaliteti është i lartë, dhe ku sistemi gjyqësor është i ngulfatur me lënde të pazgjdhura.

Përfaqësuesit e bizneseve të pranishme në këtë konferencë e vlerësuan si shumë të rëndësishëm vendimin e kryetarit Veseli duke thënë se kjo iniciativë është tepër e rëndësishme për zhvillimin e bizneseve dhe në përgjithësi të ekonomisë kosovare.



EFSE DF vazhdon përkrahjen për revistën “The Kosovo Banker” deri në fund të vitit 2016



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Frankfurt dhe Prishtinë [15 maj, 2015]- Departamenti për Zhvillim në kuadër të Fondit European për Europën Juglindore (EFSE DF) do të vazhdojë përkrahjen e tij për revistën “The Kosovo Banker” (“Bankieri i Kosovës”) deri në fund të vitit 2016.

EFSE DF e ka përkrahur revistën “The Kosovo Banker” e cila publikohet nga Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) që nga viti 2013, përmes asistencës financiare si dhe ka dhënë kontributin e saj redaktues në ndërlidhje me projektet e EFSE DF-së në Kosovë. Revista shërben si një mjet i rëndësishëm i cili ofron informata të besueshme mbi zhvillimet aktuale në industrinë bankare për publikun e gjerë në Kosovë. “The Kosovo Banker” publikohet dy herë në vit në gjuhën shqipe dhe angleze dhe shtypet në 10,000 kopje për çdo edicion, kjo revistë shpërndahet përmes postës dhe me të përditshmen kombëtare “Koha Ditore”. Aktualisht është revista e vetme e kësaj natyre në Kosovë.

Përveç kësaj, EFSE DF do të sigurojë fonde për një vit për “Periodikun Bankar”, që është pasqyrë mujore mbi indikatorët kryesorë të sektorit financiar, i cili ka filluar të publikohet së fundmi nga SHBK-ja. Çdo muaj, publikimi trajton çështje specifike të sistemit financiar që kryesisht përqendrohet në sektorin bankar në Kosovë.

“Duke pasur parasysh se edukimi financiar përbën një pjesë të rëndësishme të agjendës sonë mbi Përgjegjësinë Financiare, ne e vlerësojmë tejet lartë këtë partneritet”, theksoi Markus Aschendorf, Udhëheqës i Komitetit të EFSE DF-së. “SHBK është dëshmuar si një partner i rëndësishëm në përmirësimin e nivelit të edukimit financiar në Kosovë”.

“Industria bankare në Kosovë është e prirë për të promovuar edukimin financiar në mesin e konsumatorëve të saj si dhe të publikut të gjerë. Ky është projekti i parë i kësaj natyre dhe sigurisht se do të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e edukimit financiar në Kosovë. Shpresojmë se në të ardhmen do të ketë edhe projekte të tjera të ngjashme, në të cilat ne do të mund të bashkëpunojmë me organizatat tjera lokale dhe ndërkombëtare për ta shtyrë edhe më tej përpara këtë kauzë”, shtoi Petrit Balijs, Drejtor Ekzekutiv i SHBK-së.

Disa fjalë rreth EFSE DF

Departamenti për Zhvillim në kuadër të Fondit European për Europën Juglindore (EFSE DF) është themeluar në vitin 2006 me qëllim të përkrahjes së mandatit të EFSE's për zhvillim financiar. Misioni i tij është që të ofrojë asistencë teknike inovative, efektive, dhe të synojë drejt rritjes së ndikimit dhe rrezeveprimit të mandatit të Fondit për zhvillim financiar, në vendet e synuara. Shërbimet për ngritje të kapaciteteve të EFSE DF përshijnë ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimet, përkrahjen e sektorit financiar, si dhe hulumtimet e aplikuara me qëllim të forcimit të kapaciteteve dhe operacioneve të brendshme të organizatave partnere kredi-dhënëse të Fondit.

EFSE DF operon në mënyrë të pavarur nga Fondi përmes një marrëveshjeje mirëbesimi, sipas ligjeve të Luksemburgut. Anëtarët e Komitetit për Lehtësim të Zhvillimit (DFC) janë Banka Zhvillimore KfW (Development Bank – KfW), Agjencioni Zvicëran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Banka Zhvillimore e Austrisë (Oesterreichische Entwicklungsbank – OeEB) ndërsa

Kompania Financiare e Holandës (FMO) është përgjegjëse për vlerësimin dhe aprovimin e të gjitha propozimeve rreth projekteve, si dhe ofron udhëzime strategjike për EFSE DF.

Disa fjalë rreth Fondit Europian për Europën Juglindore

Fondi Europian për Europën Juglindore (EFSE) është iniciuar nga KfW Development Bank (KfW) më përkrahje financiare nga Ministria Federale e Gjermanisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim; dhe Komisioni Europian. Ai ka për qëllim të nxisë zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin në Shqipëri, Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovë, Gjeorgji, Moldavi, Mal të Zi, Rumani, Serbi, Ukrainë, dhe në Turqi. Pasi që qasja në financa është faktor kyç për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, EFSE përqendrohet në ofrimin e asistencës për sektorët financiar lokal në ngritjen e kapaciteteve të tyre për financim adekuat dhe të qëndrueshëm.

Fondet që EFSE i ofron si financim afatgjatë, kryesisht për ndërmarrjet mikro dhe të vogla (NMV) – por gjithashtu edhe për amvisëritë private në formë të kredive për rregullimin e shtëpive – kanalizohen tek këta klientë huamarrës përmes organizatave lokale partnere dhe të kreditimit. Mbështetës i aktiviteteve investuese të EFSE-së është Departamenti për Zhvillim i EFSE-së (EFSE DF), i cili institucioneve partnere për kreditim iu ofron asistencë teknike, konsulencë dhe shërbime të trajnimit për të ndërtuar kapacitete operacionale dhe kuadër drejtues profesional.

Inicuar nga Banka Zhvillimore (KfW) më 15 dhjetor 2005 nga katër programet e donatorëve të shumtë, nën drejtimin e saj, EFSE-ja është partneriteti i parë publiko-privat i llojit të vet, dhe fondi i parë i menaxhuar në mënyrë private në sektorin e financave për fuqizimin e zhvillimit të fondeve private për financimin e NVM-ve në rajonin e synuar.

Kapitali është ofruar nga agjencitë donatore, institucionet financiare ndërkombëtare dhe investitorë institucional privatë, duke përfshirë Ministrinë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), Komisionin Europian (KE), Qeverinë e Shqipërisë, Mbështetja për kredi Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme CJSC (SMBCS), një filialë e Bankës Qendrore të

Armenisë, Banka për Zhvillim e Austrisë (Oesterreichische Entwicklungsbank – OeEB), Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Agjencia Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar (Danida), KfW-ja si investitori kryesor, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), Kompania Financiare e Holandës (FMO), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Europiane e Investimeve (BEI), Sal. Oppenheim dhe Deutsche Bank.

Oppenheim Asset Management Services S.à r.l., Luksemburg, dhe Financat në lëvizje (Finance in Motion GmbH), nga Gjermania, janë menaxhues të fondit të EFSE-së, përkatësisht Këshilltar të këtij Fondi.

Për më shumë informacione në lidhje me Fondin Europian për Europën Juglindore, ju lutemi vizitoni: <http://www.efse.lu/>

Disa fjalë rreth Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK)

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) përfaqëson sektorin bankar në Kosovë duke bashkëpunuar me Qeverinë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, mediat dhe publikun. Qëllimi i SHBK-së është të mbështesë një sistem të shëndoshë bankar dhe konkurrencë të drejtë dhe të hapur, si dhe edukimin financiar për klientët bankarë, dhe në këtë mënyrë të nxisë zhvillimin ekonomik afatgjatë në Kosovë.

SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave duke ofruar një platformë të vetme për të diskutuar iniciativat e reja. SHBK gjithashtu identifikon dhe rishikon nismat ligjore dhe rregullative, koordinon aktivitetet e përbashkëta për sektorin bankar, dhe promovon aktivitetet bankare tek audienca e gjerë

E themeluar në vitin 2002, SHBK-ja është një pikë kryesore referimi në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me sektorin bankar në Kosovë. SHBK përfaqëson tetë banka komerciale: Bankën Ekonomike, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën për Biznes, IsBank, NLB Prishtina, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank dhe TEB Bank. SHBK-ja është zëri i industrisë bankare në Kosovë.

Banka ProCredit dhuron 150,000 çanta të pambukut

Banka ProCredit së bashku me bankat tjera simotra të rajonit kanë ndërmarrë iniciativë mjedisore e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve për mbrojtjen e ambientit duke reduktuar përdorimin e qeseve të plastikës.

Për këtë qëllim, rreth 600,000 çanta 100% pambuk organik janë shpërndarë FALAS - ku 150,000 prej tyre janë dhuruar qytetarëve të

Kosovës përmes degëve tona, qendrave tregtare dhe rrjeteve të marketeve. Vlen të theksohet se këto çanta janë prodhuar sipas standardeve më të larta ekologjike duke dëshmuar edhe tutje qasjen shumë të përgjegjshme të Bankës ProCredit ndaj mbrojtjes së ambientit.

E ardhmja në duart tuaja!



Banka ekonomike dhuron donacion për ndërtimin e qendrës së komunitetit të Down Syndrome Kosova

Banka Ekonomike, gjatë organizimit të mbrëmjes së bamirësisë të organizuar nga Shoqata Down Syndrome Kosova, ka dhuruar donacion për ndërtimin e qendrës që do të ofrojë shërbime për komunitetin dhe fëmijët e prekur me sindro-

min Down. Ky donacion është pjesë e përkushtimit të vazhdueshëm të Bankës Ekonomike për ngritjen e vetëdijësisë dhe përgjegjësisë sociale të shoqërisë sonë.



BKT angazhohet për shoqërinë

BKT angazhohet në shumë projekte të lidhura me mjedisin, komunitetin dhe përgjegjshmëri në sociale, në mënyrë që të japë një kontribut për shoqërinë, si dhe të krijojë vlera për vendin duke paguar taksa, duke ofruar produkte dhe shërbime cilësore dhe përmes krijimit të mundësive për punësim. Përshkrimi i konceptit të përgjegjshmërisë sociale të BKT-së është i bazuar në parimin "Kontribo për shoqërinë". Nga kjo pikëpamje në mënyrë direkte ose indirekte BKT mbështet artet e ndryshme, sportin si dhe aktivitetet e edukimit. Instrumentet e



BANKA KOMBETARE TREGTARE

përgjegjshmërisë sociale më të rëndësishme të BKT-së janë sponzorizimet, aktivitetet dhe disa vepra bamirësie që reflektojnë vlerat e institucionit ndaj shoqërisë dhe të punësuarve.

Raiffeisen ndihmon Qendrën e komuniteteve

Në një ceremoni solemne, z. Helmut Breit në emër të fondit bamirës H. Stepic CEE Charity (fond ky i perkrahur nga Raiffeisen Bank International) dhe Kryesues i Bordit Mbikqyres për Raiffeisen Bank në Kosovë ja ka dorezuar donacionin në vlerë prej 32,000 Euro Znj. Elizabeth Gowing, themeluese e organizatës The Ideas Partnership. Përmes këtij donacioni, Qendra e Komuniteteve në Fushe Kosovë ka hapur një cerdhe për fëmijet ashkali, egjiptas dhe romë si dhe aktivitete të tjera mbështetëse që do të ofrojnë mundësi të reja për arsimimin e këtyre fëmijeve.



IFC-ja dhe NLB Prishtina punojnë së bashku për të rritur efikasitetin e energjisë në Kosovë

IFC-ja, anëtare e Grupit të Bankës Botërore, dhe NLB Prishtina, pjesë e grupit më të madh bankar nga Sllovenia po punojnë së bashku për të investuar në rritjen e efikasitetit të energjisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të amvisërive në Kosovë. IFC-ja do të mbështesë bankën që të përmirësojë kapacitetin e saj të brendshëm për të gjetur, vlerësuar dhe financuar projekte për efikasitet të energjisë në vend. Projekti këshillohet me NLB Prishtina është pjesë e Programit të Financimit të Qëndrueshëm të Energjisë nga IFC-ja në Evropë dhe Azi Qendrore, që implementohet në partneritet me Ministrinë Federale të Financave të Austrisë. Programi ofron një

gamë të gjerë të shërbimeve këshilluese për institucionet financiare, klientët e tyre dhe palët e tjera të tregut në mbështetje të investimeve në efikasitet të energjisë.



Dielli TEB Open 2015

Përkushtimi i bankës TEB për të rinjtë e Kosovës vjen si rezultat i përgjegjësisë sociale që ky institucion merr përsipër. Pasi që sporti është aktivitet i shëndetshëm dhe efektiv për trupin dhe trurin e njeriut dhe duke e konsideruar numrin e madh të talentëve në Kosovë, banka TEB vazhdimisht i përkrah edhe tenistët e vendit. Tashmë, TEB-i është përkrahëse e turneut të tenisit "Dielli TEB Open" për 6 vitet e fundit.

Ky turne vitin e kaluar e shënoi edicionin e 14-të, por shtytja e dhënë nga kjo bankë ia ka rritur vlerën dhe profesionalizmin atij. Në këtë turne, garat zhvillohen në dy konkurrenca, në atë individuale dhe të çifteve. Ndër pjesëmarrësit e turneut janë tenistët më të mirë nga ranglista e Kosovës. Këto mbështetje që kjo bankë i bënë janë në pajtim të plotë me politikën e sponsorimit të TEB - BNP Paribas për t'i ndihmuar lojtarët e rinjë drejt suksesit në fushë, shkollë dhe jetë.



BPB mendon për të vegjëlit - mbështetë *One to One Children's Fund* dhe projektin "Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur"

BPB në vazhdimësi rikonfirmon përkushtimin e saj për të mbështetur projekte të cilat rezultojnë në rritje të mirëqenies së komunitetit që na rrethon. BPB ka mbështetur organizatën "One to One Children's Fund" në mënyrë që t'ju mundësojmë fëmijëve me aftësi të kufizuara t'ju krijohet një ambient sa më i këndshëm.

Përmes kësaj iniciative është blerë kuzhina dhe pajisjet tjera për kuzhinë për qendrën ditore të

fëmijëve si dhe iu është mundësuar furnizimi me material për pikturim në mënyrë që të angazhohen dhe të argëtohen në aktivitete të ndryshme. BPB gjithashtu ka mbështetur realizimin e projektit "Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur", me qëllim të promovimit të shëndetit oral në rreth 200 institucione parashkollore dhe fillore nëpër disa komuna, për rreth 25,000 fëmijë - nxënës.



Ziraat Bank

Ziraat Bank, banka më e madhe e Turqisë është një bankë sovrane (kapitali aksioner i Bankës është 100% në pronësi të Nënsekretariatit Turk të Thesarit), e themeluar në vitin 1863. Banka është një grup bankar komercial dhe individual me shërbime të plota që ofron një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve për më shumë se 30 milion klientë të korporatave, komercial, individual dhe ndërkombëtar anembanë Turqisë dhe disa tregje ndërkombëtare.

Banka ofron produktet dhe shërbimet e saj për klientët e saj nëpërmjet një franshize të fortë lokale dhe rrjeti ndërkombëtarë të degëve, e cila deri më 31 Dhjetor 2014 përfshinte 1682 degë lokale dhe 25 degë ndërkombëtare (rrjeti ndërkombëtar i shërbimit më i madh se çdo bankë tjetër Turke³). Banka ka degë, filiale dhe sipërmarrje të përbashkëta operacionesh në Gjermani, Bosnje dhe Hercegovinë, Azerbajxhan, Turkmenistan, Uzbekistan, Kazakistan dhe Rusi. Rrjeti i Bankës përfshin shtatë filiale në Turqi të cilat fokusohen në sigurim, lizing, pensione, menaxhim portofoliosh, broker të letrave me vlerë dhe të teknologjisë informative për të plotësuar biznesin kryesor bankar.

Sipas Shoqatës së Bankave të Turqisë, më 31 Dhjetor 2014 Banka ishte banka më e madhe në Turqi në aspektin e gjithsej pasurive (TL 247.6 miliardë), më e madhe në aspektin e gjithsej depozitave (TL 153.3 miliardë) dhe më e madhe për nga numri i degëve (1,707). Me 31 Dhjetor 2014 Banka ka pasur 23,617 të punësuar.

KOSOVË

Si pjesë e strategjisë ndërkombëtare bankare, Banka synon të vazhdojë të përmirësojë praninë e saj ndërkombëtare për të integruar produktet dhe shërbimet e njësisve vendore përmes një modeli të biznesit të orientuar më shumë nga klientët dhe marketingu; të rrit efikasitetin dhe profitabilitetin në vendet në të cilat operon; të kontribuoj në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike ndërmjet Turqisë dhe vendeve pritëse; të marrë një pjesë më të madhe të financimit tregtarë të jashtëm dhe të kanalizoj tregtinë e transaksioneve tregtare të Bankës; dhe të siguroj se rrjeti ndërkombëtar i Bankës ofron shërbime në kohë dhe efikase për klientët e tyre. Fokusi kryesor i Bankës ka qenë në rajonet e Ballkanit dhe Azisë qendrore, pasi këto



zona kanë tregtim të fortë dhe lidhje gjeografike me Turqinë.

Banka, në përputhje me strategjinë e saj bankare ndërkombëtare, synon të siguroj produkte e shërbime bankare të korporatave dhe individëve përmes një strukture të mirë dhe tregu të definuar dhe një modeli të biznesit të orientuar drejt klientëve në Kosovë.

Banka është e pozicionuar mirë për të adresuar nevojat e grupeve të ndryshme të konsumatorëve të saj me produkte dhe shërbime me porosi nëpërmjet një strategjie efikase dhe të fokusuar drejt marketingut, me qëllim të themelimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të gjata me konsumatorët.

Banka synon të marrë një pjesë në rritje të financimit të tregtisë së jashtme dhe të ruaj avantazhin që ka me rrjetin ndërkombëtarë më të madh të shërbimeve se cdo bankë tjetër Turke, kjo strategji do të shërbej klientët tanë në Kosovë të fuqizojnë biznesin e tyre në secilin vend në të cilin Ziraatbank është e pranishme.

Produktet dhe shërbimet kryesore të Bankës që do të ofrohen për klientët e saj të korporatave dhe individuale përfshijnë kredi me para të gatshme dhe pa-para të gatshme, shërbime financiare në lidhje me importin dhe eksportin e transaksioneve, financim i tregtisë, financim projektsh, shërbime bankare ndërkombëtare (letrat e konfirmimeve të kreditit, letrat e kreditit dhe zbritje të letrave të premtimit, letra e çështjeve të garancisë, arkëtimet dhe remitancat), shërbimet e ndërmjetësimit financiar (të siguruara nëpërmjet degëve të Bankës, filialeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta).

Banka parashikon të zgjeroj rrjetin e degëve të saj në Kosovë në momentin e caktuar të kohës.

3 Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata e Bankave të Turqisë

Publikimet e Shoqatës së Bankave të Kosovës

“The Kosovo Banker” është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit dhe ka për qëllim të informojë saktë publikun lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Për më tepër informata, drejtohuni tek web faqja e

Shoqatës së Bankave të Kosovës
www.bankassoc-kos.com.

Revistat e botuara:



“Vështrimi Periodik mbi Sektorin Financiar të Kosovës” është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë.

Çdo publikim mujor do të trajtojë çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore do të kenë sektorin bankar në Kosovë.
www.bankassoc-kos.com.

Publikimet mujore të publikuara deri më tani:



Qendra për Trajnime Bankare



TRAJNIMET E MBAJTURA GJATË VITIT 2014

- Risku Operacional
- NVM: Nga biznes plani deri tek financimi
- European Foundation Certificate in Banking (EFCB)
- Përmirësimi i shërbimit ndaj klientëve, shitjeve dhe negociimit
- Bazat e Marketingut Digjital
- IFRS
- Menaxhimi i Riskut Kreditor
- Menaxhimi i Zyrës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve dhe Teknikat e Shitjes
- Detektimi dhe Parandalimi i Mashtrimeve
- Modelimi i Proceseve në Biznes
- CISCO Siguria Kibernetike
- FATCA
- Aftësi të Leximit dhe Ndikimit tek Njerëzit
- Shprehitë dhe Aftësitë e Liderëve

Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Gendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës:

038 246 171
kbtraining@bankassoc-kos.com
www.bankassoc-kos.com



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION